



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 75

Tiranë – E enjte, 5 maj 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 312, datë 27.4.2016	Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme”, 2016–2018 4307
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 314, datë 27.4.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagesë të qirasë për disa familje që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti “Komuna e Parisit–Rruga e Kavajës””..... 4318
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 27.4.2016	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pronës me emërtimin “Klubi Sportiv Dinamo”, Tiranë..... 4318
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 316, datë 27.4.2016	Për përcaktimin e masës së financimit, nga buxheti i vitit 2016, për bashkësitë fetare tradicionale që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave..... 4323
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016	Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike..... 4324
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 318, datë 27.4.2016	Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për të ndërmarrë dhe zhvilluar procedurat për dhënie koncesioni/partneriteti publik privat, me objekt ndriçimin publik në territoret e njësive administrative vendore, në kuadër të programit të eficiencës së energjisë..... 4324
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 27.4.2016	Për përcaktimin e procedurës e të metodës së testimit të varieteteve..... 4325
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 27.4.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”..... 4337

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 27.4.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH-2010), si metadatë”.....	4337
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 323, datë 27.4.2016	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 391, datë 6.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës lidhëse midis rrugëve “Qemal Stafa” dhe “Esat Bordi”, si dhe ndërtimi i lulishtes në pjesën jugore të bulevardit “Aqif Pasha”, te “Xhamlliku para sahatit”, në Bashkinë e Elbasanit”.....	4338
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 324, datë 27.4.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 432, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga hapja dhe sistemimi i disa segmenteve të rrugës “11 Nëntori” (sot rruga “Qemal Stafa”) në qytetin e Elbasanit”.....	4340
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 27.4.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 205, datë 9.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga hapja dhe ndërtimi i unazës veriore, segmenti A-B, në lagjen “11 Nëntori”, hapja dhe sistemimi i zgjatimit të unazës së brendshme, segmenti që bashkon rrugën “28 Nëntori” me rrugën “Rinia”, si dhe hapja e sistemimi i zgjatimit të rrugës “Lef Nosi”, lagjja “5 Maji”, segmenti B-C, të Bashkisë së Elbasanit”.....	4343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 27.4.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass Fier (objekte)”.....	4345
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 27.4.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv Rrashbull–Golem – Kavajë.....	4347
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 10, datë 3.5.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar.....	4350

**VENDIM****Nr. 312, datë 27.4.2016**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR
TË VEPRIMIT “PËR PARANDALIMIN
DHE LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË
PASURIVE KULTURORE TË
LUAJTSHME”, 2016–2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme”, 2016–2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Poseduesit privatë, që kanë në zotërim objekte të trashëgimisë kulturore të luajtshme, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, i regjistrojnë ato në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, Akademia e Shkencave dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**PLAN KOMBËTAR VEPRIMI
PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN
KUNDËR TRAFIKIMIT TË PASURIVE
KULTURORE TË LUAJTSHME
2016–2018**

I. Hyrje

Trafiku i paligjshëm i trashëgimisë kulturore është një nga format e krimit transnacional që ndikon jo vetëm në kulturën, por edhe në ekonominë e vendeve të origjinës, transitit dhe atyre të destinacionit përfundimtar. Qeveria shqiptare, në programin e saj ka parashikuar si një nga prioritetet e punës, luftën kundër krimit të organizuar, ku përfshihet edhe lufta kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme. Në shprehje të vullnetit për të luftuar veprimtarinë kriminale ndaj pasurive kulturore të luajtshme, Policia e Shtetit ndërmori iniciativën për hartimin e

Planit Kombëtar të Veprimit “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme, 2016–2018”. Ky dokument u hartua me kontributin e institucioneve kombëtare përgjegjëse që merren me luftën kundër trafikimit të veprave të artit e kulturës, si: Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit me strukturat e saj: Sektori Kundër Trafikeve të Paligjshme, ZQK Interpol Tirana, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Departamenti për Sigurinë Publike, Drejtoria Kundër Krimit Financiar, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit); Ministria e Kulturës: Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore; Qendra e Studimeve Albano-logjike; Agjencia e Shërbimit Arkeologjik; Komiteti Shqiptar i Kulteve; Ministria e Financave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Qëllimi i planveprimit kombëtar është harmonizimi i përpjekjeve të institucioneve përgjegjëse, rritja e bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe njëkohësisht adaptimi i mjeteve e metodave ligjore më efikase, nga të gjitha institucionet kombëtare përgjegjëse, në luftën kundër vjedhjes e trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme.

Baza ligjore e Planit Kombëtar të Veprimit

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”.

Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

Ligji nr. 8523, datë 9.9.1999, “Për aderimin e RSH-së në Konventën e UNESCO-s për mjetet e ndalimit dhe të parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësive të pasurisë kulturore”.

Ligji nr. 9806, datë 17.9.2007, “Për aderimin e RSH-së në Konventën e Evropiane, “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike”” (të rishikuar).

Ligji nr. 10027, datë 11.12.2008, “Për aderimin e RSH-së në Konventën, “Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore””.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 663, datë 17.7.2013, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013–2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013–2016”.



Analizë

Shqipëria është një vend me trashëgimi kulturore, në fushën e arkeologjisë, objekteve me interes paleontologjik, prehistorik, numizmatik, etnografik, të qytetërimit antik e mesjetar, dorëshkrimeve, kodikëve, mbishkrimeve, qyteteve muze, parqeve, objekteve të kultit, vepra të arteve pamore etj.

Situata e trafikimit të veprave të artit e kulturës gjatë viteve të fundit, paraqitet më pak shqetësuese dhe madje më e kontrolluar krahasuar me periudhat e mëparshme. Shqipëria ka zbatuar një sërë politikash dhe strategji të përshtatshme gjatë viteve të fundit, të cilat janë vlerësuar edhe nga raportet ndërkombëtare.

Fenomeni i trafikimit të veprave të artit e të kulturës, nuk është problem vetëm i Shqipërisë, por një problem ndërkombëtar me përmasa për të gjithë botën. Në trafikun ndërkombëtar të pasurive kulturore të luajtshme ekzistojnë njëkohësisht vendet e origjinës, vendet ku këto objekte kalojnë transit dhe vendet me destinacion tregu. Vendi ynë kryesisht, nuk evidentohet si një vend destinacioni për pasuritë kulturore të luajtshme, por më tepër një vend origjine, me destinacion tregun e jashtëm.

Numri i objekteve të trashëgimisë sonë kulturore, të trafikuar jashtë shtetit është i madh, referuar faktit të vjedhjes së tyre në të kaluarën (referencë vitet 90 e këtej) apo kërkesës së tregut të jashtëm për këto objekte.

Gjithashtu, është i njohur fakti i gërmimeve të paligjshme nëpër qendrat arkeologjike historike apo kërkimeve nënujore, të kryera nga shtetas shqiptarë apo të huaj, të cilët kanë për qëllim, gjetjen, përvetësimin dhe trafikimin e pasurive kulturore të luajtshme jashtë shtetit. Ndërkohë, ka të dhëna për ndërtime të reja, me ose pa leje nga organet kompetente mbi objekte apo banesa monument kulture apo me vlera për trashëgiminë kulturore. Për parandalimin e goditjen e rasteve të tilla është rritur bashkëpunimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe është forcuar kontrolli në territor nga strukturat e policisë.

Gjithashtu, janë evidentuar raste të vjedhjes së ikonave (ikonostaseve) nëpër kisha, kryesisht në rajonin juglindor dhe jugperëndimor të Shqipërisë me qëllim trafikimin e tyre jashtë vendit.

Ruajtja e objekteve apo vendeve ku ekspozohen e depozitohen vlera të trashëgimisë kulturore, është një problem që lë hapësira për abuzime nga

elemente me prirje kriminale në drejtim të kërkimeve të paligjshme, përvetësimit, vjedhjes së pasurive kulturore të luajtshme.

Lufta kundër vjedhjes dhe trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme, për Policinë e Shtetit përbën një ndër angazhimet e saj, në kuadrin e përgjithshëm të luftës kundër krimit të organizuar.

Nga hetimi i rasteve dhe informacionet e grumbulluara, rezulton se pasuritë kulturore të luajtshme të vjedhura apo të përvetësuara në rrugë të paligjshme në Shqipëri, trafikohen jashtë vendit si nëpërmjet pikave të kalimit kufitar apo edhe jashtë tyre.

Kalimi nëpërmjet vendkalimeve kufitare është i mundshëm, kryesisht për shkak të mungesës së eksperiencës dhe njohurive të pamjaftueshme në fushën e pasurive kulturore të paluajtshme, të autoriteteve përgjegjëse në pikat e kalimit kufitar (si dogana apo policia kufitare), kamuflimit të tyre në mjete të rënda me mallra apo anije transporti, falsifikimit të dokumentacionit shoqërues, përmasat e vogla të objekteve që trafikohen etj.

Shqipëria ka vlerësuar rekomandimet e Komisionit Evropian pasqyruar në Raportet e Progresit për Shqipërinë dhe do të vazhdojë të përforcojë masat e ndërmarra për luftën kundër krimit të organizuar, veçanërisht do të sigurojë implementimin e masave të ndërmarra në luftën kundër, trafikeve të paligjshme.

Është forcuar bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe pjesëmarrjes në operacionet e përbashkëta. Në funksion të zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar kundër krimit të organizuar janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi dy- e shumëpalëshe me vende dhe organizata rajonale e ndërkombëtare. Instalimi i linjave të sigurta të komunikimit ka sjellë rritje të ndjeshme të shkëmbimit të informacionit me EUROPOL, zyrat ndërlidhëse të vendeve të Bashkimit Evropian dhe ato të palëve të treta, të atashuara pranë këtij organizmi.

Në sajë të koordinimit të mirë të strukturave përgjegjëse për parandalimin e goditjen e trafikimit të veprave të artit e të kulturës, rritjes së kapaciteteve profesionale të efektivave, rritjes sasiore e cilësore të hetimeve proaktive me metoda speciale të hetimit, për periudhën 2013–2015, janë evidentuar 22 vepra penale, “Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës”, me 29 autorë.



Bashkëpunimi

Hetimi i rasteve të vjedhjes dhe të trafikimit të pasurisë kulturore të luajtshme kërkon një nivel të caktuar të njohurive në fushën e pasurive kulturore të luajtshme, e për rrjedhojë kërkohet një bashkëpunim i institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit në fushën e hetimit të veprave penale, policisë dhe prokurorisë (trajtime nga specialistë të artit e kulturës dhe trashëgimisë kulturore).

Informacionet paraprake që merren për vjedhjen dhe trafikimin e pasurive kulturore apo bllokimin e tyre nga autoritetet policore homologe, për vetë natyrën specifike të kësaj veprë penale, kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet strukturave të hetimit, agjencive dhe institucioneve të specializuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, si dhe me Zyrën Qendrore Kombëtare të Interpolit e Prokurorinë.

Kështu, në raste të bllokimit të pasurive kulturore të luajtshme me origjinë nga Shqipëria, nga autoritete homologe kërkohen detaje që vërtetojnë origjinën e kësaj veprë si përmasat e objektit, lloji i materialit, vendgjetja e tij, vendi i ruajtjes, numri i inventarit, fotografi e detaje të tjera që vërtetojnë origjinën dhe pronësinë e një veprë (pasaporta e objektit).

Shqipëria vitet e fundit ka bërë një progres të dukshëm, duke aderuar në instrumente evropiane dhe ndërkombëtare, të cilat e lehtësojnë bashkëpunimin në fushën penale sikurse dhe duke nënshkruar një numër të madh marrëveshesh dypalëshe.

Burimet e financimit

Plani i veprimit është parashikuar të ketë një kosto indikative të përgjithshme prej 182,239,106 lekësh.

Këto kosto do të mbulohen tërësisht nga buxheti i shtetit, përkatësisht përmes programeve të PBA-së të Ministrisë së Punëve të Brendshme, programi i Policisë së Shtetit (nënprogrami “Hetimi i krimit”), si dhe të Ministrisë së Kulturës, programi Mbështetje për Art-Kulturën, si edhe programi trashëgimisë.

Nga përlogaritja e koston për Policinë e Shtetit rezulton se shuma e përfshirë 124,209,388 lekë është e përfshirë brenda tavaneve të PBA-së 2016–2018.

Nga përlogaritja e koston për Ministrinë e Kulturës rezulton se shuma e përfshirë 58,029,718 lekë është e përfshirë brenda tavaneve të PBA-së 2016–2018.

Konstatime

Nga analiza e kryer “Planit kombëtar të veprimit 2012–2014”, u konstatua si më poshtë:

- Institucionet kombëtare të cilat kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin e vjedhjes dhe trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme janë: Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme për Planifikimin Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor – Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare (6 DRKK, Durrës, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Berat, Shkodër); institucionet fetare, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Shërbimi Informativ Shtetëror, bashkitë, arkivat etj. Midis këtyre institucioneve dhe Policisë së Shtetit ekziston një bashkëpunim në drejtim të shkëmbimit të informacionit, por kërkohet një koordinim dhe bashkërendim më i mirë i aktiviteteve.

- Mungesa e një inventari të saktë me të dhëna të detajuara (fotografi dhe të dhëna të tjera identifikuese) për pasuritë kulturore të luajtshme, të vjedhura e përvetësuara në vite në muzetë apo institucionet e tjera kulturore dhe fetare në Shqipëri, pas viteve 90, si dhe gjatë vitit 1997 e më pas.

- Mungesa e Inventarit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Muzetë kombëtare dhe lokale, institucionet që posedojnë objekte dhe fonde të trashëgimisë kulturore, si dhe poseduesit dhe koleksionistët privatë, antikuaristët janë ende shumë larg zbatimit të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore” dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”.

- Mungesa e licencimit dhe e regjistrimit të koleksionistëve privatë dhe dyqaneve të antikuriatit dhe pajisja e tyre me një leje të veçantë për ushtrimin e aktivitetit pas regjistrimit të të gjitha objekteve të trashëgimisë kulturore që posedojnë në databazën kombëtare pranë Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

- Pamjaftueshmëri bashkëpunimi ndërinstitucional (rajonal) ndërmjet strukturave përgjegjëse në luftë kundër fenomenit të kërimit të paligjshëm, përvetësimit, vjedhjes dhe trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme.



- Nevoja e grupeve të ekspertëve, të ndarë sipas tipologjive kryesore të objekteve të trafikuar dhe specifikimi i kompetencave të tyre.

- Ekzistenca e një tregu informal në tregtinë e pasurive kulturore të luajtshme brenda vendit, pasi kemi të bëjmë me një aktivitet tregtar (pikturat që shiten nga autorë të ndryshëm, shitja e objekteve të ndryshme në pazarin e Krujës, në Shkodër, Tiranë etj.)

- Mangësi në ndërgjegjësimin e publikut, e programeve të edukimit për pasojat e ekzistencës së tregut të paligjshëm të pasurive kulturore të luajtshme, nxjerrjes së tyre jashtë kufijve.

- Ndërgjegjësimi i komunitetit sipas grup-moshave (hartimi i kurrikulave në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në funksion të këtij procesi).

- Hartimi dhe përdorimi i kontratave tip me përdorimin e monumenteve të kulturës nga të tretët në rastet e zhvillimit të aktiviteteve që kanë në fokus promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore (në këto parashikohen dhe masat në rastet e dëmtimit të monumentit).

- Mungesa e një liste të ekspertëve me njohuri specifike në fushën e pasurive kulturore të luajtshme, në dispozicion të autoriteteve policore dhe prokurorisë, për dhënien e vlerësimeve në rastet e sekuestrimit të objekteve të dyshuara si vepra arti.

Plani i veprimit përmban këto elemente:

- Objektivat;

- Llojet e veprimtarive që do të kryhen;

- Institucionet përgjegjëse;

- Burimet financiare dhe partnerët e mundshëm në zbatimin e detyrës;

- Treguesit e arritjeve të pritshme.

Objektivat

Për parandalimin e trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme synohet të realizohen këta objektiva kryesorë:

1. Krijimi dhe përditësimi i Inventarit të Fondit Kombëtar të Pasurive Kulturore. Përcaktimi i afatit kohor të detyrueshëm, 2016–2018, për zbatim nga institucionet që posedojnë dhe administrojnë objekte apo fonde të pasurive kulturore.

2. Përmirësimi i kuadrit ligjor që rregullon fushën e trashëgimisë kulturore në funksion të forcimit të luftës kundër trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.

3. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror apo lokal, për të maksimizuar përpjekjet e të gjitha institucioneve të përfshira në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme.

4. Fuqizimi i kapaciteteve teknike dhe profesionale përmes organizimit të trajnimeve dhe të takimeve të përbashkëta.

5. Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e trafikimit të paligjshëm përmes nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

6. Ndërgjegjësimi në komunitet mbi trafikimin e paligjshëm dhe pasojat e tij.



OBJEKTIVA SPECIFIKË

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1. Parandalimi i trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme përmes krijimit dhe përditësimit të bazave të të dhënave kombëtare të objekteve. 1.1 Përgatitja e një udhërrëfyese përmbledhës në bazë qarku në lidhje me fondet e trashëgimisë kulturore, parqeve arkeologjike, muzeve historike kombëtare, lokale, tipologjisë të shtetit në rrethe, objekteve të kultit, me status monumenteve të kulturës, institucione dhe godina që ruajnë e ekspozojnë trashëgimi kulturore. Një kopje e këtij udhërrëfyese depozitohet në QKIPK. 1.2 Inventarizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në QKIPK, përfundimi i inventarit të objekteve të humbura, si dhe lidhja e <i>data base-s</i> së QKIPK-së me pikat e kalimit kufitar (PKK). 1.3 Të ndahen dyqanet e antikuariatit nga dyqanet e artizanatit. Dyqanet e antikuariatit të pajisin detyrimisht objektet e tyre me kartelat e regjistrimit të QKIPK-së. Të krijohet lista e dyqaneve të antikuariatit për të gjithë Shqipërinë. 1.4 Përgatitja e hartës GIS: databaza e informacionit arkeologjik mbi veprimtarinë në terren të ASHA-së (vëzhgime intensive arkeologjike të shpëtimit, gjetjet rastësore). Dhe, mbi veprimtarinë e Institutit Arkeologjik (QSA) për Gërmimet Shkencore. Harta GIS të depozitohet pranë institucioneve përgjegjëse në mënyrë që të njihen si zona me potencial arkeologjik të ngarkuara me ligj për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore si parandalim për gërmimet klandestine dhe në funksion të parandalimit për luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore. 1.5 Institucionet shtetërore që administrojnë objektet e trashëgimisë kulturore në të gjithë vendin duhet të depozitojnë pranë QKIPK-së një kopje të regjistrimit themeltar të fondit të objekteve muzeore, galerive, fondeve të institucioneve, pasaportat e objekteve, si dhe dosjet e plota të objekteve të trashëgimisë kulturore që posedon rrjeti muzeal dhe fondet e këtyre institucioneve, me qëllim krijimin e një inventari kombëtar të plotë dhe të saktë të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe katalogimin informatik të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar, si dhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore. 1.6 Identifikimi dhe katalogimi i objekteve në pronësi private të paidentifikuara më parë dhe si rrjedhojë të pakataloguara. Zbatimi i ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “për trashëgiminë kulturore” bëhet i detyrueshëm për të gjitha objektet që dalin jashtë shtetit, qoftë për një afat të përcaktuar, qoftë përgjithmonë (për shitje), dhurim apo ndryshim vendbanimi, duhet të regjistrohen në bazën e të dhënave për të marrë lejen përkatëse. Kur janë pronë private ato kontrollohen nga Komisioni Shtetëror i Vlerësimit, i cili i sugjeron Ministrit të Kulturës veprimtarinë e mëtejshme, pra lejimin apo moslejimin e lëvizjes, konform ligjit.	D.V. Policisë&DRKK, Muze Kombëtar dhe Lokal, instit. që i administrojnë këto fonde. QKIPK; Bashkia, qarku MK; QSA; DRKK; QKIPK; bashkitë MK; QKIPK; DPD; ASHA & donatorë ASHA dhe donatorë MK; QSA; IA; IMK; IAKSA; GKA; QKIPK; DRKK; bashkitë QKIPK; DPPSTKM MK; DRKK; bashkitë; DPSH	2016 i detyrueshëm për institucionet që posedojnë dhe administrojnë fonde të pasurive kulturore. 2016–2018 i detyrueshëm përmes një urdhri apo VKM-je për institucionet që posedojnë dhe administrojnë fonde të pasurive kulturore. 2016-2018 i detyrueshëm përmes një urdhri apo VKM-je për institucionet që posedojnë dhe administrojnë fonde të pasurive kulturore.	1.1 Njohja e situatës, në nivel qarku në drejtim të vlerave të trashëgimisë kulturore, vendeve e mënyrën ruajtjes, si dhe gjendjes së riskut, për objektet e trashëgimisë kulturore. 1.3 Kartela e unifikuar dhe baza kombëtare e të dhënave përbëjnë një sukses, ligjor dhe praktik, pasi ato do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në luftën antitrafik. Kartela të jetë me numëror, me letër të veçantë dhe me elemente sigurie. 1.4 Lehtësimin e proceduarve për kërkimin, gjetjen dhe rikthimin e objekteve të vjedhura dhe të trafikuar jashtë shtetit. 1.5 Monitorimi i situatës kundër kërkimeve të paligjshme arkeologjike, tregimit të paligjshëm dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës. 1.6 Regjistrimi i objekteve që përbëjnë pasuri ose trashëgimi kulturore dhe certifikimi i tyre.	1.1 MPB: 4,170,285 lekë/për 3-muaj MK: 1,000,000 lekë 1.2 MK: 3,000,000 lekë 1.3 MK: 45,429,718 lekë 1.4 MK/ASHA: 3,500,000 lekë 1.6 MK: 200,000 lekë



2. Përmirësimi i kuadrit ligjor me qëllim të forcimit të luftës kundër trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore. 2.1 Rishikimin e kodit penal duke përfshirë ndëshkimet për veprat penale në fushën e arkeologjisë, si dhe kallëzim penal për veprat që konstatohen. 2.2 Hartimi i projekteve për rregullime ligjore, për sa u përket individëve që veprojnë në tregun e veprave të artit (si p.sh., koleksionistë të ndryshëm, numizmatë, filatelistë, antikuaristë, që shesin sende të vjetra me vlerë). Në mënyrë të veçantë në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe ato tatimore e financiare të realizohet koordinimi i nevojshëm për të rregulluar shitblerjen e këtyre objekteve, veçanërisht në tregun e pazarit të Krujës, Gjirokastrës, Beratit, Korçës, ku përveç riprodhimeve të këtyre objekteve me vlerë që shiten si suvenire, shpesh përfundojnë edhe objekte origjinale që disponohen nga individë, të cilët në mungesë të ndërgjegjësimit dhe vështirësive financiare i shesin kundrejt vlerave të papërfillshme. 2.3 Përfshirja në kriteret e marrjes së lejes zhvillimore të raportit të vëzhgimit (survey) arkeologjik. 3. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet trajnimeve dhe analizave të përbashkëta për të mbështetur luftën ndaj trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme. 3.1 Krijimi i grupit ndërinstitucional të punës, për monitorimin e luftës kundër vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës, me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi të çdo institucioni përgjegjës (DPSH, DPD, QSA etj.) 3.2 Hartimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me bashkitë për ruajtjen dhe mbrojtjen e zonave arkeologjike dhe me potencial arkeologjik. 3.3 Përbushjen e detyrimeve ligjore të parashikuara në Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet QKIPK-së dhe DPD-së në respektimin e mbrojtjes së pasurive kulturore të popullit shqiptar, si aspekt i rëndësishëm i identitetit kombëtar. QKIPK-ja është institucioni i ngarkuar me ligj për inventarizimin, kartelizimin, katalogimin informatik dhe nxjerrjen e pasaportës së objekteve të trashëgimisë kulturore. Ajo ka të drejtën e përgatitjes së dokumentacionit për lëvizjen e objekteve, pavarësisht nga pronësia mbi to, brenda e jashtë vendit. DPD-ja ka përgjegjësinë ligjore për kontrollime import-eksportit të objekteve të trashëgimisë kulturore. 3.4 Krijimi i pikave të kontaktit ndërmjet DPSH, DPPSTDK dhe QKIPK në Ministrinë e	Prokurori; Sektori Task-Forcë, IKMT; institucione, homologë MK; QKIPK MK; ASHA; bashkitë MK; QKIPK; DPD; DRKK-të. MK; ASHA: bashkitë; DRKK-të QKIPK; DPD; DPSH QKIPK; DPD; DPSH; IA; IAKSA; DPPSTKD	2016–2018 2016 2016–2018 2016 2016	2.1 Bashkëpunim me Prokurorinë dhe Sektorin Task-Forcë, IKMT dhe shkëmbim eksperience me institucione homologe evropiane. 2.2 Bazë ligjore e miratuar, për një bashkëpunim më të mirë ndërinstitucional, me qëllim parandalimin dhe goditjen e fenomeneve që ndikojnë në cenimin e pasurive të trashëgimisë kulturore. 3.3 Rritja e efikasitetit të strukturave të specializuara në drejtim të parandalimit të trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore. 3.4 Shkëmbim i shpejtë i informacionit, për	2.2 MK: 500,000 lekë 3.2 MK/ASHA: 300,000 lekë



Kulturës dhe QSA. Krijimi i pikës së kontaktit ndërmjet QKIPK-së dhe DPD-së.			situata dhe probleme emergjente në lidhje me problematikën e vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës dhe ekspertimi e vlerësimi pa vonesë i tyre.	
3.5 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucionalë, me qëllim aksesin në databazën e QKIPK-së për shkëmbimin e shpejtë dhe të saktë të informacionit për çdo objekt të trashëgimisë kulturore.	PSH; MK; QKIPK.	2016–2018	3.5 Krijimin e lehtësirave të nevojshme për një kontroll më efikas në pikat e kontrollit kufitar-doganor, për parandalimin e trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.	
3.6 Të forcohet kontrolli në hyrje-dalje të P. K. Kufitar të vendit tonë nëpërmjet zbatimit të rregullave strikte të kontrollit dhe gjetjes së formave e metodave më efektive për identifikimin e trafikantëve të veprave të artit e kulturës.	DPSH; DPPSTKD; QKIPK; IA; IAKSA;	2016–2018	3.6 Parandalimi i trafikimit të veprave të artit të vjedhura apo të gjetura nga gërmime të paligjshme.	
3.7 Shfrytëzimi i faqes ASF 2 të Interpolit, si dhe atë të QKIPK-së, për vepra arti të vjedhura e shpallura në kërkim ndërkombëtar, si dhe ato që tentojnë t'i kalojnë në mënyrë të paligjshme jashtë shtetit, nëpërmjet kufirit shtetëror.	MK; DPPSTKD.	2016–2018	3.7 Identifikimi i veprave të artit të vjedhura në tentative trafikimi, nëpërmjet kontrollit selektiv të bagazheve të personave të dyshuar. Kapjen në flagrancë të trafikantëve të veprave të artit të vjedhura dhe bashkëpunëtorëve të tyre.	
3.8 Zbatimi i sanksioneve administrative të parashikuara në ligjin e trashëgimisë kulturore, në çdo rast të konstatimit të shkeljeve të dispozitave të parashikuara në këtë ligj.	PSH-MK; QKIPK	2016–2018	3.8 Ndëshkimi administrativ i personave, të cilët kapen në shkelje të dispozitave ligjore të parashikuara nga ligji i trashëgimisë kulturore.	3.8 MPB: 16,681,140 lekë për pagesën në masën 50% të pagës për 2 vjet
3.9 Zbatimi i praktikave më të mira, për grumbullimin e të dhënave prej burimeve të kualifikuara të informacionit, për persona apo grupe personash të përfshirë në aktivitetin e paligjshëm, të vjedhjes trafikimit të veprave të artit, si dhe kërkimeve të paligjshme arkeologjike apo nënujore.	DPSH (D.P. për Kufirin&Migracionin) DPPSTKD QKIPK, Interpol-Tirana MK; DPPSTKD DPD	2016–2018	3.9 Evidentimi i personave të cilët dyshohet se merren me aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të veprave të artit dhe kulturës.	3.9 MPB: 16,681,140 lekë për pagesën në masën 50% të pagës për 2 vjet
3.10 Mbështetja e strukturave për hetimin e trafikut të paligjshëm në produktet analitike të hartuara nga strukturat e analizës së informacionit kriminal me qëllim orientimin e hetimeve proaktive.			3.10 Rekomandimet e produkteve analitike “Vlerësimi i kërcënimit të krimit të organizuar”, “Vlerësimi i grupeve Kriminale” etj.	3.10 MPB: 27,732,696 lekë për 2 vjet
3.11 Publikimin e operacioneve të suksesshme kundër vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit dhe kulturës.	DPSH, DPD, Dr. vendore të policisë.	2016–2018	3.11 Ndërgjegjësimi i opinionit për pasojat penale në rast të implikimit në veprimtarinë e paligjshme në dëm të trashëgimisë kulturore.	3.11 MPB: 2,849,496 lekë për 2 vjet
3.12 Bashkëpunimi me Zyrën Qendrore Kombëtare Interpol-Tirana dhe DPD-së, për rastet e shpalljes, anulimit dhe komunikimin me zyrat analoge, për kërkimin gjetjen dhe kthimin në origjinë të veprave të artit e kulturës të vjedhura në Shqipëri dhe të blokuara jashtë shtetit.			3.12 Lehtësimi i procedurave të kërkimit gjetjes dhe riadhesimit të veprave të artit të vjedhura në vendin tonë dhe të trafikuar jashtë vendit.	3.12 MPB: 2,849,496 lekë për 2 vjet
3.13 Strukturat rajonale të policisë të mbajnë kontakte të vazhdueshme dhe të shkëmbejnë të dhëna me institucionet që ruajnë, administrojnë dhe ekspozojnë objekte me vlera të			3.13. Marrja në kohë e të dhënave për veprimtari të paligjshme, në fushën e	3.13 MPB: 16,681,140 lekë në masën 50% të pagës për 2 vjet



trashëgimisë kulturore (drejtoritë e muzeve, si kombëtare dhe lokale, zyrtat e administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike, DRKK-të, QSA etj.), për sa i përket sigurisë së këtyre objekteve, ekspeditave kërkimore apo dhe kërkimeve të paligjshme arkeologjike të nëntokës dhe nënuijt nga persona të paautorizuar që synojnë përvetësimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.			kërkimeve të paligjshme arkeologjike, përvetësimin të objekteve me vlerë për trashëgiminë, dhe parandalimin e vjedhjes dhe trafikimit të tyre, si dhe penalizimin e personave të përfshirë.	
4. Fuqizimi i kapaciteteve ndërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në planveprim. 4.1 Hartimi i kalendarit të takimeve me grupet e interesit dhe shoqërinë civile. 4.2 Kryerja e trajnimeve të përbashkëta, për njohje të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e veprave të artit e kulturës, format e trafikimit të veprave të artit, dhe teknikat proaktive të hetimit . 4.3 Formimi i një grupi të ekspertëve me njohuri specifike në fushën e veprave të artit e kulturës sipas llojit (arkeologji, etnografi, pikturë, skulpturë, numizmatike etj.) me qëllim kryerjen e ekspertimeve përkatëse, si dhe trajnimin e personelit lidhur me njohuri në këtë fushë. 4.4 Fushatë informimi për institucionet që depozitojnë dhe kanë përgjegjësi administrimi, objekte me vlera të trashëgimisë kulturore, në lidhje me procedurën ligjore që duhet të ndiqet në rast konstatimi të vjedhjes apo dëmtimit të vlerave që kanë në administrim; rolin dhe detyrën funksionale të institucioneve përgjegjëse të ngarkuara me ligj. 4.5. Njohja nga strukturat e policisë dhe doganave të modelit të dokumentacionit shoqërues me të cilën një vepër arti e blerë, e dhuruar apo për qëllime ekspozimi lëviz jashtë territorit të Shqipërisë. Afishimi i këtij modeldokumenti në pikat e kalimit kufitar dhe doganor. Pasaporta e objektit e lëshuar nga QKIPK-ja përcakton dhe statusin e objektit trashëgimi ose jo. Në pikat e kalimit të kufirit e vetmja leje ligjore për objektet e trashëgimisë kulturore është ajo e lëshuar nga MK-ja dhe QKIPK-ja. DPD-ja, në përputhje me Kodit Doganor dhe “Për dispozitat zbatuese të kodit doganor”, ligjit “Për trashëgiminë kulturore”, ka detyrimin e ndalimit të të gjitha objekteve të trashëgimisë kulturore që dalin jashtë vendit pa dokumentacion të rregullt ligjor (pasaportën e objektit të lëshuar nga QKIPK-ja, urdhrin e ministrit të Kulturës ose të vendimit Këshillit të Ministrave).	Shoqata e ndërtuesve; subj. licens. arkeologji, organizata e OJQ të fushës etj. MK; ekspertë dhe institucione të specializuara QSA; DPPSTDK; QKIPK DPSH; DPD; DTK; QKIPK; DPSH DPD QKIPK	2016–2018 2016, 2017, 2018 2016–2018 2016–2018	4.2 Një trajnim në vit me 20 pjesëmarrës nga DPSH-ja dhe MK-ja. 4.3 Hartimi i një liste të ekspertëve përkatës me njohje të posaçme për gjini të ndryshme në drejtim të njohjes dhe vlerësimit të veprave të artit e kulturës si në rastin e hetimeve, gjetjen e objekteve të ndryshme dhe trajnimin e personelit. 4.4 Ndërgjegjësimi i autoriteteve dhe i komunitetit në përgjithësi për vlerat e trashëgimisë kulturore dhe njohja e detyrimeve dhe procedurave për autoritetet përgjegjëse. 4.5 Minimizimin e mundësive të kalimit të kundërligjshëm të veprave të artit nëpërmjet pikave të kalimit kufitar.	4.2 MK: 1,500,000 lekë 4.4 MPB: 8,340,570 lekë në masën 50% të pagës për 1 vit MK/QPIK: 200,000 lekë 4.5 MK/QKIPK/GKA 200,000 lekë



4.6 Krijimi i një bërthame specifike policore në qendër dhe bazë, pranë Drejtorisë për Narkotikët dhe Trafiket (pjesë e strukturave për trafikun e paligjshëm) e cila të trajnohet në vazhdimësi për një punë më të specializuar kundër vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës. Në shkollën e policisë të futen programe mësimore që japin informacione formuese për arkeologjinë, veprat e arteve pamore, objektet e kulturës materiale dhe shpirtërore, pra të futet lënda e historisë së artit dhe kulturës shqiptare dhe botërore. Ndërkohë, të bëhen trajnime urgjentisht dy herë në vit, 1-javore, me përfaqësues të çdo qarku për të pasur personel më të kualifikuar. Personat e trajnuar të merren në provim për dënimin e marra. Të futet në programin mësimor për të gjithë studentët e shkollës së policisë vizitat në Galerinë Kombëtare të Arteve, Muzeun Historik Kombëtar, në disa qendra arkeologjike, si në Apoloni dhe Butrint. 4.7 Zhvillimi i trajnimeve me punonjësit e policisë, doganave, për shtimin e njohurive profesionale që lidhen me trashëgiminë kulturore në tërësi, legjislacionin për veprat e artit e kulturës. Konkretisht, shihet si më emergjente që nga specialistë pranë DPPSTD-së, QSA-së, QKIPK-së, duhet të ofrohen kurse trajnimi për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe doganave si në qendër ashtu edhe në rajone të ndryshme në Shqipëri, kryesisht nëpër zonat ku janë më tepër të përqendruara vlerat e trashëgimisë kulturore. Kurset e trajnimit të jenë me punonjës të përzgjedhur policie dhe atyre të doganave me rezultate të larta në lëndët mësimore. Këto kurse duhet të jenë të përhershme me një program vjetor dhe kohëzgjatje 2-javore secili. Normalisht 2 herë në vit. Kursi do të jetë i kombinuar edhe me vizita në galeri dhe muze arti, në disa qytete sipas programit. Biblioteka e Qendrës së Formimit Policor të ketë në fondet e saj për studentët botime të ndryshme për artin dhe kulturën shqiptare dhe botërore. Derisa të plotësohet fondi i kësaj biblioteke edhe me kalime inventari dhe dhurata nga institucionet në varësi të MK-së, mund të shfrytëzohen bibliotekat e disa institucioneve të ndryshme të specializuara, si: - Biblioteka e Universitetit të Arteve; - Biblioteka Kombëtare; - Biblioteka e GKA, Tiranë; - Biblioteka e IMK; - Biblioteka e QSA. 4.8 Trajnimi i oficerëve të policisë (specialistëve të L.K. Trafikeve të paligjshme), në drejtim të njohjes së legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e veprave të artit e kulturës (ligji i trashëgimisë kulturore, Konventa e UNESCO-s etj.) format e trafikimit të veprave të artit dhe mjetet e metodat më efektive hetimore në luftë kundër këtij fenomeni. Përvetësimi i praktikave më të mira (nga hetimet, trajnimet, brenda dhe jashtë vendit) në funksion të një pune më të mirë kundër fenomenit të vjedhjes. 4.9 Të rritet ndërgjegjësimi ndërmjet punonjësve të institucioneve kombëtare përgjegjëse (policisë, doganave, Dr. Tr. Kulturore, arkivave, organeve të pushtetit lokal) për bashkëpunimin ndërmjet tyre për rritjen e efektshmërisë, së punës në drejtim të parandalimit të vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit dhe hetimeve me profesionalizëm të rasteve të evidentuara për këtë fenomen. 4.10 Të rritet ndërgjegjësimi i opinionit publik për dëmet dhe efektet negative për kulturën	DPSH MK; QSA; QKIPK; MASH QSA DTK QKIPK MK; GKA; QKIPK; DPD; DPT; QSA; DRKK QKIPK DPP DPD DRKK	2016	4.6 Rritja e treguesve të punës policore, në drejtim të evidentimit të problematikës dhe marrjen e masave për parandalimin dhe goditjen e aktivitetit kriminal në fushën e vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës (n.p.m. një struktura solide policore të specializuar). 4.7 Njohja e veprave të artit në tërësi, pasuritë dhe trashëgimitë kulturore të vendit, objektet më të rrezikuara apo që synohen nga trafikantët. 4.8 Njohja e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për veprat e artit dhe kulturës, format e metodat efektive hetimore në këtë drejtim. 4.9 Rritja e efikasitetit të punës së institucioneve kombëtare përgjegjëse për parandalimin dhe goditjen e këtij aktiviteti kriminal. 4.10 Botime të ndryshme, për efektet	4.6 MPB: 372,000 lekë për trajnim 4.7 MK: 1,500,000 lekë 4.10 MK: 500,000 lekë
---	---	-------------	--	---



dhe shoqërinë shqiptare, që sjell fenomenin e vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës. Publikimi i rasteve të penalizimeve apo arrestimeve të kryera nga policia në lidhje me vjedhjen dhe trafikimin e veprave të artit e kulturës. 4.11 Rritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për identifikimin, administrimin dhe ruajtjen e objekteve pasuri kulturore e luajtshme. 4.12 Njehsimi i katalogut të humbjeve në databazën e QKIPK-së me faqen ASF 2 të Interpolit me qëllim që të kemi një informacion të saktë dhe në kohë në nivel ndërkombëtar. Të mundësohet plotësimi i të dhënave të objekteve të humbura sipas formatit të Interpolit (objekt ID). T'i kërkohej Zyrës së Interpol - Tirana mundësimi i këtij formati. 4.13 Bashkëpunimi me qëllim evidentimin dhe regjistrimin e pasurive të trashëgimisë kulturore në pronësi dhe përdorim të institucioneve fetare. 4.14 Rritja e numrit të hetimeve proaktive në bashkëpunim me prokurorinë.	QKIPK DPP DPD KSHK MK QKIPK; Interpol Tirana; MPB. DPPSTKD; QKIPK;	2016–2018 i detyrueshëm përmes një urdhri apo VKM-je 2016–2018	negative, për kulturën, ekonominë dhe shoqërinë shqiptare, që sjell fenomenin e vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës, me pjesëmarrës nga institucionet kombëtare përgjegjëse. 4.12 Rritja e zbulueshmërisë së veprave penale për trafikimin e veprave të artit me 1.4% në vitin 2018 në raport me vitin 2014, në sajë të implementimit të sistemit të INTERPOL-it dhe sistemit TIMS. 4.13 Krijimi i një baze të dhënash ku të regjistrohen, me të dhëna të plota dhe foto, pasuritë e trashëgimisë kulturore në posedim të enteve të kultit (sipas formatit të objekteve, të inventarizuara nga QKIPK-ja. 4.14 Rritja e numrit të operacioneve me metodat speciale të hetimit të trafikeve të paligjshme me 5% deri në vitin 2018, krahasuar me 2014.	4.12 MPB: 118,729 lekë/për 1 muaj 4.13 MK: 200,000 lekë 4.14 MPB: 27,732,696 lekë për 2 vjet
---	---	--	---	---



Shkurtime e përdorura

KM	Këshilli i Ministrave
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
DPSH	Drejtoria e Policisë së Shtetit
MK	Ministria Kulturës
DPPSTDK	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor
QKIPK	Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore
GKA	Galeria Kombëtare e Arteve
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
DRKK	Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare (Durrës, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Berat, Shkodër)
ZAKPA	Zyrat e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike
ASHA	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
MHK	Muzeu Historik Kombëtar
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
QSA	Qendra e Studimeve Albanologjike
IAKSA	Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit
IA	Instituti i Arkeologjisë
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
PP	Prokuroria e Përgjithshme

Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza

Monitorimi bëhet në zbatim të Planit të Veprimit për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme nga grupi ndërinstitucional të punës, për monitorimin e luftës kundër vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës, me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi të çdo institucioni përgjegjës (DPSH, DPD, QSA etj.)

Analizimi i punës së bërë në këtë plan veprimi për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme dhe evidentimi i arritjeve për çdo fazë të implementimit të objektivave të planveprimit.

Rritja e numrit të procedimeve penale dhe hetimeve proaktive.

Përbërja e grupit teknik ndërinstitucional të punës do të jetë si më poshtë:

- Drejtoria Përgjithshme për hetimin e krimit të organizuar dhe krimet e rënda (Sektori për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm).

- Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor.

- Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

- Galeria Kombëtare e Arteve.

- Instituti i Monumenteve të Kulturës.

- Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

- Muzeu Historik Kombëtar.

- Qendra e Studimeve Albanologjike.

- Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit.

- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

- Prokuroria e Përgjithshme.

- Shërbimi Informativ i Shtetit.

Grupi teknik do të përgatisë një raport të plotë vjetor për masat e marra dhe arritjet në lidhje me zbatimin e planin e veprimit.

(Në raport do të pasqyrohet shkalla e arritjes së indikatorëve vit pas viti.)

Si indikatorë kryesorë për monitorimin e performancës do të jenë:

- Rritja e zbulueshmërisë të veprave penale për trafikimin e veprave të artit me 1.4% në vitin 2018 në raport me vitin 2014, në saje të implementimit të sistemit të INTERPOL-it dhe sistemit TIMS.

- Krijimi i një baze të dhënash ku të regjistrohen, me të dhëna të plota dhe foto, pasuritë e trashëgimisë kulturore në posedim të enteve të kultit (sipas formatit të objekteve të inventarizuara nga QKIPK-ja.

- Rritja e numrit të operacioneve me metodat speciale të hetimit të trafikeve të paligjshme me 5% deri në vitin 2018, krahasuar me 2014-n.

- Krijimi dhe përditësimi i inventarit të fondit kombëtar të pasurive kulturore nga institucionet që posedojnë dhe administrojnë objekte apo fonde të pasurive kulturore.

- Fuqizimi i kapaciteteve teknike dhe profesionale përmes organizimit të trajnimeve dhe të takimeve të përbashkëta.

- Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe hetimeve të përbashkëta.

Ndërgjegjësimi në komunitet mbi trafikimin e pasurive kulturore të luajtshme dhe pasojat.

**VENDIM****Nr. 314, datë 27.4.2016**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 230, DATË 13.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGESË TË QIRASË PËR DISA FAMILJE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “UNAZA E MADHE E TIRANËS, SEGMENTI “KOMUNA E PARISIT-RRUGA E KAVAJËS””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2015, “Për buxhetin e shtetit për vitin 2016”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe të ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas lidhjes 2, të vendimit nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet lidhja 2/1, që përmban listën emërore të subjekteve që do të trajtohen me qira.

2. Vlera shtesë për pagesën e qirasë për subjektet e shtuara në lidhjen 2/1, në masën prej 12 150 000 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.

3. Afati dyvjeçar për përfitimin e qirasë prej këtyre subjekteve nis nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 2/1

Nr.	Subjektet që trajtohen me pagesë të qirasë të cilët preken nga zbatimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti “Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës””
1	Sul Kruja
2	Ahmet Kruja
3	Ibrahim Balla
4	Petrit Doka
5	Ahmet Kruja (2)
6	Andrea Panariti

7	Bashkim Kruja
8	Qerim Doka,
9	Xhemal Kruja (2)
10	Xhemal Kruja (1)
11	Petrit Kruja
12	Lulzim Gjoshi
13	Amet Ymeri (2)
14	Ahmet Ymeri (3)
15	Shaban Kodra
16	Gëzim Shaba
17	Kujtim Zgura
18	Shqipe Peza
19	Halil Gjapi
20	Nail Tafilaku
21	Mehdi Haskasa
22	Sami Haskasa
23	Ibrahim Balla
24	Përparim Gatali
25	Bujar Muharremi
26	Ardian Muharremi
27	Fatjon Muharremi
28	Saimir Shaku dhe Zamira Muharremi
29	Gëzim Jashari
30	Hyrije Karamani
31	Astrit Demiri
32	Esat Jashari
33	Vagner Bushka
34	Suzana Bregasi
35	Kujtim Hysmeta
36	Murat Tafilaku
37	Musa Bleta
38	Myhyrije Ymeri
39	Petrit Velia
40	Ylli Ymeri

VENDIM**Nr. 315, datë 27.4.2016**

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË PRONËS ME EMËRTIMIN “KLUBI SPORTIV DINAMO”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “d”, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pronës me emërtimin “Klubi Sportiv Dinamo”, Tiranë, me numër pasurie 832, përkatësisht në administrim të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për komponentët e saj me numrat rendorë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 e 9, dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme për komponentin me numër rendor 10, sipas formularit 3, bashkëlidhur këtij vendimi, për ta përdorur për ushtrimin e funksioneve të veta kulturore dhe sportive.

Komponenti me numër rendor 2, “Godina kryesore”, dhe trualli i saj do të mbetet në përdorim të Agjencisë së Shërbimit të Sporteve (ASHS).

2. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, përfshirë dhe ato të krijuara nga marrëdhëniet kontraktore të lidhura për pronën me numër pasurie 832, me emërtimin “Klubi Sportiv Dinamo”, Tiranë, dhe komponentët e saj nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 e 10, bashkë me fondet e miratuara për këtë qëllim, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi i transferohen Bashkisë Tiranë.

3. Për pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të reflektohen ndryshimet përkatëse në listën e pronave të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendimin nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të qarkut të Tiranës”.

4. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, dhe ta tjetërsojë atë.

5. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Financave, kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE										
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)										
Institucioni i Pushtetit Qendror MRP (Klubi Sportiv Dinamo Tiranë)					Identifikoi : Grupi i Punes					
Bashkia / Komuna Tiranë					Shef.Sek.Administrim Prones Y.Myslimaj					
Fusha e përdorimit te Prones :Ruajtje Rendi					Spec. Ing.L. Shkupi Spec. Ing.A. Hallvaxhiu					
					Supervizoi : Miratoi : Ministri i Rendit Publik Z. Luan Rama					
Nr. Rendi	Zona Kadast Indeks Hartes	Nr. Pasurisë	Emertesa e prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet Perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Pernasat e prones ne m2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Prane Pishinave dhe Kopshtit Zoologjik Rr."Grigor Heba"Nr.1							Ardhur Me shkresen Nr.133 Dt.18.07.2002
1			Klubi Sportiv Dinamo		Truall Total	75917				
2	B	832		Godina kryesore		1194	Hotel-Zyra	MRP	K.S.Dinamo	
3	B	832		Dushe,garderobe		175	Dushe-Garderobe	MRP	K.S.Dinamo	
4	B	832		Palester e lojrave		1929	Palester	MRP	K.S.Dinamo	
5	B	832		Fusha futbollit 2		17556	F.Futbollit 2	MRP	K.S.Dinamo	
6	B	832		Fusha tenisi 2		1088	F.Tenisi 2	MRP	K.S.Dinamo	
7	B	832		Fusha basketbollit 2		1287	F.Basketbollit 2	MRP	K.S.Dinamo	
8	B	832		Fusha volejbollit 1		552	F.Volejbollit 1	MRP	K.S.Dinamo	
9	B	832		Rruge e asfaltuar		4000 ml	Rruge te brendsh.	MRP	K.S.Dinamo	
0	A	832		Truall sportiv prane Stadiumit "Q.Stafa"		11130	Truall	MRP	K.S.Dinamo	



17.11.1994 **KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME** Vol. 25, Fq. 93

IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

8270 NR.i PASURISE: 8/9 --> Vijon nga: Vol. _____, Fq. _____

TR-S.T-9,10-U,V-9. Vijon në: Vol. _____, Fq. _____ deri në: Vol. _____, Fq. _____ -->

Pasurisë: Rrethi Tirane Q/F Tirane **PERFUNDIMTARE (data): 25/11/2010**

Rr/L DIGA E LIQENT P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____

SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Nji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N. : PO, Ref PL RREG

Nr. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Trual	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesi	Per pjesen e përbashket:
<u>75,917.00</u> m ²	1. <u>75,917.00</u> m ²	1. _____ m ²	<u>PALLAT</u>
f. <u>11656</u>	Ref. <u>11656</u>	Ref. _____	Kuota e pjesmarries: _____ %
<u>75,917.00</u> m ²	2. <u>75,917.00</u> m ²	2. <u>1,610.00</u> m ²	Nr i Pasurise (pallat): _____
f. <u>19565</u>	Ref. <u>19565</u>	Ref. <u>19565</u>	Vol. _____ Faqe _____
_____ m ²	3. _____ m ²	3. _____ m ²	
f. _____	Ref. _____	Ref. _____	
_____ m ²	4. _____ m ²	4. _____ m ²	
f. _____	Ref. _____	Ref. _____	

Përshkrim i veçantë:
SIP NDERTESE JANE HOTELI DHE ZYRAT SI DHE DUSHE, GARDEROBE.

SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
19565	14/12/2010	REPUBLIKA SHQIPERISE				1	TIRANE Rruga DIGA E LIQENT				



D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Data e regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
22/11/2010	FR	ME VENDIMIN NR. 73/1996 KQKP I NJIKET E DREJTA E PARABLERJES PER SIP 960 M2 TRASHEGIMTAREVE LIGJOR TE ZEF KOVACI			
21/11/2011	FR	ME VENDIMIN E K K PRONA VE NR. 157 DATE 31.07.1995 PANDELI KOSTURIT (TRASHEGIMTAREVE TE TU) I LIND E DREJTA E PARABLERJES SE OBJEKTIT KLUBIT SPORTIV OLIMPIK KUR AJ TE PRIVATIZOHEJ PER SIP 658 M2			
00030707	IS	NE ADMINISTRIM DHE PERGJEGJESI TE MINISTRISE ARSIMIT DHE SPORTIT		VKM 595 DT 1009/2014	

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikates	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tiranë

TIRANË, me 29 / 9 / 2014

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 25 , Faqe 93 , Zona Kadastrale 8270 , Qyteti Tiranë






HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

Andrea Mico



A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE **8270**NR. I PASURISE: **8/9**VOL **25**FQ **93**INDEKSI I HARTES: **TR-S.T-9.10-U.V-1** SHKALLA: **1:3000**ADRESA E PASURISE: Rrethi **Tirane**Q/F **Tirane**Rr/L: **DIGA E LIQENIT**

P/G

SH

K **Ap**

B. KUFIZIMET

V. _____
L. _____
J. _____
P. _____


C. PRONARI

REPUBLIKA
SHQIPERISE

D. Data: **29/09/2014**Ora: **1:36:47PM**

X: 400285.135
Y: 4576479.249

X: 400860.603
Y: 4576479.241



X: 400285.135
Y: 4576002.999

X: 400860.603
Y: 4576002.999

**VENDIM****Nr. 316, datë 27.4.2016****PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
FINANCIMIT, NGA BUXHETI I VITIT
2016, PËR BASHKËSITË FETARE
TRADICIONALE QË KANË
NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME
KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 6, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare tradicionale, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit, nga buxheti i vitit 2016, prej 109 000 000 (njëqind e nëntë milionë) lekësh, e miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, të përdoret, si më poshtë vijon:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 31 416 000 (tridhjetë e një milionë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë, të ndarë në:

i) 11 748 000 (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dyzet e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 89 punonjës të administratës;

ii) 19 668 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 149 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 25 872 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë, të ndarë në:

i) 20 592 000 (njëzet milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 156 punonjës të administratës;

ii) 5 280 000 (pesë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 punonjës të institu-

cioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 25 872 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë, të ndarë në:

i) 5 676 000 (pesë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 43 punonjës të administratës;

ii) 20 196 000 (njëzet milionë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 153 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 25 840 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e dyzet mijë) lekë, të ndarë në:

i) 3 696 000 (tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 28 punonjës të administratës;

ii) 15 144 000 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e dyzet e katër mijë) lekë, përkatësisht:

- 10 144 000 (dhjetë milionë e njëqind e dyzet e katër mijë) lekë, për ndërtimin e Teqesë së Shtutit, Gjirokastër;

- 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për ndërtimin e teqesë në Përmet.

iii) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshit Botërore, me qendër në Tiranë, dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoren për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë-preventivat e paraqitura prej saj në kërkesën e vitit 2016, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur për kryerjen e veprimtarive të parashtruara.

2. Kalimi i fondit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të bëhet brenda muajit prill të vitit 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 317, datë 27.4.2016****PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT
PUBLIK QË PËRFAQËSON SHTETIN SI
PRONAR TË AKSIONEVE TË
SHOQËRIVE TË SEKTORIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 48, pika 2, e 53, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., (OST), është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3. Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, OST-ja aplikon menjëherë pranë Entit Rregullator të Energjisë, për certifikim, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 58, të ligjit nr. 43/2015.

5. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron të drejtat mbi OST-në, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe fushën e tij të përgjegjësisë shtetërore.

6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., dhe Operatori i Shpërndarjes së

Energjisë Elektrike sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 318, datë 27.4.2016****PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT
KONTRAKTOR PËR TË NDËRMARRË
DHE ZHVILLUAR PROCEDURAT PËR
DHËNIE KONCESIONI/PARTNERITETI
PUBLIK PRIVAT, ME OBJEKT
NDRIÇIMIN PUBLIK NË TERRITORET
E NJËSIVE ADMINISTRATIVE
VENDORE, NË KUADËR TË
PROGRAMIT TË EFICIENCËS SË
ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Bashkisë Tiranë dhe Bashkisë Durrës, si autoritete kontraktore, për të marrë në shqyrtim projektin e koncesionit/partneritetit publik privat, të identifikuar dhe të propozuar nga shoqëria “HeSaLight” A/S, për sistemin e ndriçimit të Bashkisë Tiranë dhe të Bashkisë Durrës, në kuadër të programit të eficiencës së energjisë.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë të administrojë procedurat për dhënien me koncesion/PPP, në përputhje me kreun III, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM

Nr. 319, datë 27.4.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS E
TË METODËS SË TESTIMIT TË
VARIETETEVE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 33, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret, procedurat dhe metodat e testimit të varieteteve për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet (DUS) dhe vlerën e kultivimit dhe përdorimit (VKP) me qëllim regjistrimin e tyre në Katalogun Kombëtar (KK).

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, kanë të njëjtën kuptim edhe në këtë vendim.

**II. KRITERET QË DUHET TË PLOTË-
SOJË NJË VARIETET QË TESTOHET PËR
DALLUESHMËRI, UNIFORMITET DHE
STABILITET DHE PËR VLERËN E KULTI-
VIMIT DHE PËRDORIMIT**

1. Një varietet konsiderohet i dallueshëm nëse, pavarësisht nga origjina e tij nga e cila ka rezultuar, është qartësisht i dallueshëm për një ose më shumë karakteristika të rëndësishme në raport me një varietet tjetër të regjistruar si i tillë.

2. Një varietet konsiderohet i qëndrueshëm nëse pas shumëzimesh të njëpasnjëshme ose në fund të çdo cikli ai mbetet i njëjtë me përshkrimin e karakteristikave thelbësore të tij.

3. Një varietet konsiderohet uniform nëse përveç devijimeve shumë të vogla, bimët e tij shfaqin tipare dalluese gjenetike të ngjashme ose

identike me karakteristikat e përshkruara të këtij varieteti.

4. Vlera e kultivimit dhe përdorimit të varietetit konsiderohet e kënaqshme nëse krahasuar me varietetin dëshmuar të regjistruar në Katalogun Kombëtar, cilësitë e tij ofrojnë të paktën përmirësim të qartë dhe të dukshëm të kultivimit apo prodhimit ose të produkteve që rrjedhin prej tyre.

5. Provat për testimin e varieteteve për VKP-në kryhen sipas këtyre afateve:

a) Për varietetin e krijuar në vend, për 1 (një) vit;

b) Për varietetin e krijuar në shtetet anëtare të BE-së apo në shtetet që kanë nënshkruar konventën e UPOV-it, për 1 (një) vit;

c) Për varietetet e prodhuara në vendet që nuk janë anëtare të BE-së apo që nuk kanë nënshkruar konventën e UPOV-it, për 2 (dy) vite radhazi.

6. Provat për testimin e varieteteve për DUS-in, për të gjitha varietetet e bimëve bujqësore që testohen, kryhen për jo më pak se 2 (dy) vite radhazi.

7. Treguesit për vlerën e kultivimit dhe përdorimit të një varieteti që testohet për t'u regjistruar në Katalogun Kombëtar janë përcaktuar në shtojcën 1, të këtij vendimi.

8. Lejohen të vendosen në treg, pa kryer procedurat për testim:

a) farat e bimëve të familjes graminore që nuk kanë destinacion prodhimin foragjer;

b) varietetet e bimëve bujqësore, që janë miratuar në një nga vendet anëtare të BE-së ose në një nga shtetet nënshkruese të UPOV-it, me kushtin që furnizuesi të paraqesë pranë ESHFF-së skedën me të dhënat e varietetit të miratuar në vendin përkatës;

c) linjat (linjat *inbreed*, hibridet) të cilat janë të destinuara vetëm si komponentë për prodhimin e hibrideve.

**III. KUSHTET QË DUHET TË PLOTË-
SOJË SUBJEKTI PËR TESTIMIN E NJË
VARIETETI PËR TËU REGJISTRUAR NË
KATALOGUN KOMBËTAR**

1. Subjekti, që kërkon të testojë një varietet për regjistrimin në Katalogun Kombëtar, duhet të paraqesë pranë ESHFF-së:

a) kërkesën me shkrim;

b) skedën me karakteristikat e varietetit;

c) fotografi të bimës apo të frytit të saj, për kategoritë e bimëve bujqësore si drithërat, bimët

¹ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me direktivën 2002/53/EC të Këshillit, datë 13 qershor 2002, “Për katalogun e përbashkët të varieteteve të specieve të bimëve bujqësore”; nr. CELEX 32002L0053-EN. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 193, datë 20.7.2002, faqe 1–11 dhe direktiva nr. CELEX 32003L0090; nr. natyral 2003/90/CE, datë 6.10.2003, shtojca 3, faqe 10.



industriale, perimet, foragjeret, patatja, bimët medicinale dhe aromatike, bimët vajore e fibroze, pemët frutore, hardhitë dhe drurët dekorativë pyjorë;

ç) të dhëna për sasinë e farës për mbjellje të çdo varietetit;

d) të dhëna për origjinën e varietetit;

dh) faturën e pagesës sipas tarifave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Financave.

2. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për aplikim për testimin e varietetit është e përcaktuar në shtojcën 2, të këtij vendimi.

3. Për rastet kur testimi kryhet nga subjektet private, kushtet që duhet të plotësojë subjekti dhe dokumentacioni që duhet të paraqesë për testimin e një varieteti për regjistrimin e tij në Katalogun Kombëtar përcaktohen sipas procedurave që aplikohen për prokurimin publik.

4. Sasia e farës për mbjellje për çdo varietet që testohet për t'u regjistruar në Katalogun Kombëtar është përcaktuar në shtojcën 3, të këtij vendimi.

IV. PROCEDURA DHE METODA PËR TESTIMIN E NJË VARIETETI

1. Procedurat e testimit për regjistrimin e varietetit në Katalogun Kombëtar realizohen nga ESHFF-ja ose nga subjektet publike apo private, sipas përcaktimit në kreun IX, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor".

2. ESHFF-ja, bazuar në metodikat e hartuara dhe të miratuara nga Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrimin në Katalogun Kombëtar (KVVRKK), kryen provat e testimit sipas kësaj procedure:

a) Përgatit mostrat e materialit mbjellës e shumëzues bimor për t'i dërguar për mbjellje në pikat e miratuara me urdhër të ministrit për testimin e varieteteve;

b) Vendos kodin e veçantë për çdo mostër dhe bën regjistrimin e tyre në regjistrin përkatës;

c) Nënshkruan kontratë shërbimi me subjektet private fituese në konkurrimin publik, për kryerjen e provave të testimit në përputhje me kërkesat e pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor";

ç) Nënshkruan marrëveshje me subjektet publike për kryerjen e procedurave të testimit që nuk u nënshtrohen procedurave të prokurimit

publik. Forma dhe përmbajtja e marrëveshjes për kryerjen e procedurave të testimit nga subjektet publike është përcaktuar në shtojcën 4, të këtij vendimi;

d) Në bashkëpunim me subjektin publik apo privat të autorizuar, përgatit skemën e nevojshme për testim, piketimin e ngastrës dhe ndjek procedurën e mbjelljes sipas skemës përkatëse;

dh) Pajis subjektin publik apo privat të autorizuar me metodikën tip, të miratuar nga KVVRKK-ja sipas varieteteve;

e) Në përfundim të periudhës së testimit subjekti publik apo privat, i autorizuar, dorëzon të plotësuar dokumentacionin përkatës në ESHFF;

ë) Pas përfundimit të çdo testimi vjetor, ESHFF-ja duhet të plotësojë një raport të ndërmjetëm të testimit për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet. Ky raport duhet të përmbajë rezultatet paraprake të testimit për DUS-in dhe problematikën e konstatuar gjatë testimit. Forma dhe përmbajtja e formularit për raportin e ndërmjetëm është përcaktuar në shtojcën 5, të këtij vendimi.

f) Pas përfundimit të testimit ESHFF-ja plotëson raportin e testimit për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet, ku përcaktohet nëse varieteti i ri është i dallueshëm, uniform dhe i qëndrueshëm. Forma dhe përmbajtja e formularit për raportin përfundimtar është përcaktuar në shtojcën 6, të këtij vendimi;

g) KVVRKK-ja analizon rezultatet e testimit dhe merr vendim për të regjistruar në Katalogun Kombëtar varietetin, vetëm nëse është i dallueshëm, i qëndrueshëm dhe uniform, si dhe të ketë vlerë të kënaqshme për kultivim dhe përdorim;

gj) Vlerësimi i dosjes për testimin e një varieteti nga ESHFF-ja, për rastet kur kryhet nga subjektet shtetërore apo edhe për rastet kur testimi kryhet nga subjektet private, sipas përcaktimit të këtij vendimi, duhet të përfundojë brenda 45 ditëve;

h) Kur ESHFF-ja ose subjekti publik apo privat, i autorizuar, nuk e përfundon këtë procedurë brenda afatit të përcaktuar në shkronjën "gj", i interesuari dorëzon ankesën pranë ESHFF-së brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe ESHFF-ja detyrohet t'i kthejë përgjigje subjektit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit;

i) Nëse ESHFF-ja nuk i përgjigjet subjektit brenda afateve të përcaktuara më lart, atëherë i interesuari dorëzon ankesën pranë ministrit, i cili



duhet t'i kthejë përgjigje subjektit ankues brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

V. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE, PËRGATITJA E DOSJES PËR KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË VARIETETEVE

1. Sektori përgjegjës për testimin në ESHFF, si në rastet kur testi kryhet nga vetë ESHFF-ja edhe në rastin kur testi kryhet nga subjekti publik apo privat, sipas përcaktimit të këtij vendimi, përpilon një dosje me të dhëna për çdo varietet të specieve të bimëve bujqësore që testohen, e cila përmban një përshkrim të qartë të punës për zbatimin e të gjitha kërkesave të metodikës përkatëse.

2. Së bashku me dosjen e të dhënave, duhet të depozitohet dhe kampioni i nevojshëm i farës së varietetit që testohet, për kryerjen e analizave biometrike në laboratorin e referencës.

3. Laboratori i referencës, bazuar në metodikën tip, kryen analizat biometrike sipas zonave të testimit dhe pajis kampionin me fletanalizën përkatëse.

4. Bazuar në të dhënat e zonave të testimit dhe analizave laboratorike, sektori përgjegjës për testimin përgatit raportin përfundimtar për KVVRRKK-në.

5. ESHFF-ja i propozon KVVRRKK-së që të gjitha varietetet, që do të regjistrohen në Katalogun Kombëtar, të qëndrojnë të regjistruara për jo më pak se 10 vjet, ndërsa fidanët e pemëve frutore dhe ato të hardhisë të qëndrojnë të regjistruara deri në futjen e tyre në prodhim.

SHTOJCË 1

TREGUESIT QË DUHET TË PLOTËSOJË VARIETETI PËR VLERËN E KULTIVIMIT DHE PËRDORIMIT (VKP)

Treguesit janë si më poshtë:

- a) Rendimenti;
- b) Qëndrueshmëria ndaj sëmundjeve e dëmtuesve;
- c) Përshtatshmëria në lidhje me faktorët në mjedisin;
- ç) Treguesit e cilësisë.

Karakteristikat e mësipërme të një varieteti do të konsiderohen pas daljes së rezultateve përfundimtare të testimit.

VI. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Kreu IV, “Procedura dhe metodat e testimit të varieteteve që regjistrohen në Katalogun Kombëtar”, i vendimit nr. 309, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e tregimit, certifikimit dhe testimit të farës së panxharit”, kreu IV, “Procedura dhe metodat e testimit të varieteteve që regjistrohen në Katalogun Kombëtar”, i vendimit nr. 86, datë 30.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve të tregimit, certifikimit dhe testimit të varieteteve për farat e drithërave”, kreu IV, “Procedura dhe metodat e testimit të varieteteve që regjistrohen në Katalogun Kombëtar”, i vendimit nr. 87, datë 30.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve të tregimit, certifikimit dhe testimit të farave foragjere”, dhe kreu IV, “Procedura dhe metodat e testimit të varieteteve që regjistrohen në Katalogun Kombëtar”, i vendimit nr. 574, datë 24.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e tregimit, certifikimit dhe testimit të farës së patates”, shfuqizohen.

2. Ngarkohen ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**SHTOJCA 2****KËRKESË**

Për testimin dhe regjistrimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në KK, parashikuar në pikën 6, të nenit 33 të ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

A. Të dhëna për aplikuesit:

1. Emri e mbiemri: _____
2. Adresa: _____
3. Emërtimi i subjektit dhe adresa: _____
4. Vendndodhja e aktivitetit _____

B. Varietetet që kërkohen të testohen:

1. _____
2. _____
3. _____

C. Varietetet që kërkohen të regjistrohen:

1. _____
2. _____
3. _____

Kërkuesi

(Emër e mbiemri i furnizuesit ose përfaqësuesi i tij, nënshkrimi)

C. Miratimi për procedurën teknike dhe kryerjen e veprimeve financiare për likuidim.

(Të dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkohet të prodhohet):

Nr	Shërbim që do të kryhet	Kultura	Varieteti	Sasia (numri)	Tarifa lek/USD	Vlera në lek/USD
1						
2						
3						
4						

Kjo kërkesë mbahet në katër kopje, (originali në zyrën e financës) një kopje i bashkëngjitet praktikës së punës, një kopje i jepet aplikuesit dhe një në bllok.

Përgjegjësi sektorit të testimit

Financa

Tiranë, me.....

**SHTOJCA 3****SASITË E MATERIALIT MBJELLËS SIPAS SPECIEVE**

	Emri Latinisht	Emri Shqip	Sasia e farës për testim (Kg)
I	Drithërat		
1	Avena saliva L.	Tërshëra e zakonshme	5
2	Hordeum vulgare L.	Elbi	5
3	Panicum miliaceum L.	Meli	4
4	Secale cereale L.	Thekra	5
5	Sorghum bicolor (L.) Moench	Melakuqja	2
6	Sorghum sudanense Stapf.XTritico secale Wittm.	Sorgumi sudanez	2
7	xTriticosecale Witim	Tritikalet	5
8	Triticum aestivum L. Emend. Fiori et Paol.	Grurë i butë	5
9	Triticum durum Desf.	Grurë i fortë	5
10	Triticum spelta L.	Tepa	5
11	Zea mays L. (partim)	Misri	5
12	Oryza sativa L.	Orizi	4
II	Bimët foragjere,		
II -A	Barërat		
1	Agrostis sp L.	Barimëza bisht geni	0.1
2	Alopecurus pratensis L.	Bisht dhelpra e livadhit	0.1
3	Arrhenatherum elatius (L.)	Arrenatera e lartë (tërshërë)	0.1
4	Bromus catharticus Vahl	Bromusi	0.1
5	Bromus sitchensis Trin.	Bromusi i Alaskës	0.1
6	Cynodon dactylon (L.) Pers.	Grami	0.1
7	Dactylis glomerata L.	Telishi	0.1
8	Festuca arundinacea Schreber	Festuka si kallam	0.1
9	Festuca ovina L.	Festuka e deleve	0.1
10	Festuca pratensis Hudson	Festuka e livadhit	0.1
11	Festuca rubra L.	Festuka e kuqe	0.1
12	Lolium multijlorum Lam.	Loliumi	0.1



		shumëlulësh	
13	<i>Lolium perenne</i> L.	Loliumi shumëvjeçar	0.1
14	<i>Phleum pratense</i> L.	Fleumi livadhor	0.1
15	<i>Poa annua</i> L.	Flokësi njëvjeçar	0.1
16	<i>Poa nemoralis</i> L.	Flokësi e pyjeve	0.1
17	<i>Poa palustris</i> L.	Flokësi i ligatinave	0.1
18	<i>Poa pratensis</i> L.	Flokësi livadhor	0.1
19	<i>Poa trivialis</i> L.	Flokësi i zakonshëm	0.1
20	<i>Trisetum flavescens</i> (L.) P. Beauv	Triseta e zbehtë	0.1
II -B	Leguminozet		
1	<i>Lotus corniculatus</i> L.	Tërfili me brirë	0.3
2	<i>Lupinus albus</i> L.	Lupini i bardhë	1
3	<i>Lupinus angustifolius</i> L.	Lupini gjethengushtë	1
4	<i>Lupinus luteus</i> L.	Lupini i verdhë	1
5	<i>Medicago lupulina</i> L.	Jonxha lupin	0.3
6	<i>Medicago sativa</i> L.	Jonxha	0.3
7	<i>Medicago x varia</i> T. Martyn	Jonxha e ranishteve (hibride)	0.3
8	<i>Pisum sativum</i> L. (partim)	Bizelja	2
9	<i>Trifolium alexandrinum</i> L.	Tërfili aleksandrin	0.3
10	<i>Trifolium hybridum</i> L.	Tërfili hibrid	0.3
11	<i>Trifolium incarnatum</i> L.	Tërfili i kuqërremtë	0.3
12	<i>Trifolium pratense</i> L.	Tërfili livadhor	0.3
13	<i>Trifolium repens</i> L.	Tërfili zvarritës	0.3
14	<i>Trifolium resupinatum</i> L.	Tërfili persian	0.3
15	<i>Vicia faba</i> L. (partim)	Batha	2
16	<i>Vicia pannonica</i> Crantz	Grashina panoneze	2
17	<i>Vicia sativa</i> L.	Koçkulla	2
18	<i>Vicia villosa</i> Roth	Grashina	2
II -C	Bimë të tjera foragjere		
1	<i>Brassica napus</i> L var. <i>napobrassica</i> (L.) Rchb.	Sinapi	0.2



2	Brassica oleracea L.	Lakra e zakonshme	0.2
3	Phacelia tanacetifolia Benth.	Këmbanorja blu	0.2
4	Raphanus sativus L. var. oleiformis Pers.	Rrepa foragjere	0.2
III	Bimë industriale:		
1	Beta vulgaris L. ssp. vulgaris var. alba DC.	Panxhari	0.2
IV	Duhani		
1	Nicotiana tabacum L.	Duhani	0.2
V	Pambuku		
1	Gossypium hirsutum L.	Pambuku	0.2
VI	Bimët vajore dhe fibroze		
1	Brassica napus L. (partim)	Sinapi	0.2
2	Brassica nigra (L.) Koch	Lakra e zezë	0.2
3	Brassica rapa L. var. silvestris (Lam.) Briggs	Kolëza	0.2
4	Cannabis sativa L.	Kërpi	0.2
5	Glycine max (L.) Merrill	Soja	2
6	Helianthus annuus L.	Luledielli	2
7	Linum usitatissimum L.	Liri	0.5
8	Arachis hypogaeal	Kikiriku	3
VI I	Patatja		
1	Solanum tuberosum L.	Patatja	150
VI II	Perimet		
1	Allium cepa L.	Qepa	0.3
2	Allium porrum L.	Preshi	0.3
3	Allium sativum L.	Hudhra	0.3
4	Anthriscus cerefolium (L.) Hoffm.	Fier moskat	0.05
5	Apium graveolens L.	Selinon	0.02
6	Asparagus officinalis L.	Asparagusi	0.1
7	Beta vulgaris L. var. Vulgaris	Panxhari i zakonshëm	0.1
8	Beta vulgaris L. var. conditiva Alef.	Panxhari i kuq	0.3
9	Brassica oleracea L. convar. acephala (DC) Alef. var. sabellica L.	Lakra kokë (jeshile)	0.3
10	Brassica oleracea L. convar. botrytis (L.) Alef. var. botrytis	L.Lulelakra	0.3
11	Brassica oleracea L. convar. botrytis (L.) Alef. var. Cymosa	Brokoli i hollë	0.1
12	Brassica oleracea L. convar. botrytis	Brokoli kokë	0.1



	(L.) Alef. var.italica Plenck		
13	Brassica oleracea L. convar. oleracea var. gemmifera DC	Lakra e Brukselit	0.2
14	Brassica oleracea L. convar capitata (L.) Alef. var. subauda L.	Lakra e Savojës	0.2
15	Brassica oleracea L. convar. capitata (L.) Alef. var alba DC	Lakra kokëbardhë	0.2
16	Brassica oleracea L. convar. capitata (L.) Alef. var rubra DC	Lakra kokëkuqe	0.2
17	Brassica oleracea L. convar. acephala (DC) Alef. var. gongylodes	Kohlrabi	0.2
18	Brassica pekinensis (Lour.) Rupr.	Lakra kineze	0.3
19	Brassica rapa L. var. Rapa	Rilka	0.2
20	Capsicum annuum L.	Speci	0.2
21	Cichorium endivia L.	Endivia	0.01
22	Cichorium intybus L. (partim)	Çikoria	0.01
23	Citrullus lanatus (Thunb.) Matsum. et Nakai	Shalqini	0.3
24	Cucumis melo L.	Pjepri	0.3
25	Cucumis sativus L.	Trangulli	0.01
26	Cucurbita maxima L.	Kungulli i ëmbël	0.3
27	Cucurbita pepo L.	Kungulli i zakonshëm	0.3
28	Cucurbita pepo L. var. styriaca Greb	Kungulli i madh i verdhë	0.3
29	Cynara cardunculus L.	Angjinarija	0.15
30	Daucus carota L.	Karota	0.1
31	Foeniculum vulgare Miller.	Finoku	0.02
32	Hybiscus esculentus	Bamja	0.5
33	Lactuca sativa L.	Sallata	0.01
34	Lycopersicon lycopersicum (L.) Karsten ex Farë.	Domatja	0.01
35	Petroselinum crispum (Miller) Nyman ex A.ë.Hill	Majdanozi	0.01
36	Phaseolus coccineus L.	Barbunja	3
37	Phaseolus vulgaris L.	Fasulja	3
38	Pisum sativum L. fnartim) (partim)	Bizelja	2
39	Raphanus sativus L.	Rrepa	0.2
40	Solarium melongena L.	Patëllxhani	0.05
41	Spinacia oleracea L.	Spinaqi	0.1
42	Valerianella locusta (L) Laterr.	Valeriana	0.02
43	Vicia faba L. (partim)	Batha	4
44	Zea mays L. (partim)	Misri i ëmbël	5



IX	Hardhia		Nr.Fidanëve
1	Vitis spp.	Hardhia	20
X	Sumullbari (Humulusi)		
1	Humulus lupulus L.	Sumbullbari (Humulusi)	20
XI	Bimët drufrutore		Nr.Fidanëve
1	Castanea sativa Mill.	Gështenja	10
2	Citrus sinensis (L.) Pers.	Portokalli	10
3	Citrus limon (L.) Burm. f.	Limoni	10
4	Citrus reticulata Blanco	Mandarina	10
5	Citrus paradisi Macf.	Greipfrut	10
6	Citrus aurantifolia (Christm.)Sëing	Nerënxa	10
7	Citrus Medica	Qitro	10
8	Cydonia spp.	Ftoi	10
9	Cornus mas L.	Thana	10
10	Corylus avellana L.	Lajthia	10
11	Diospyros Kaki L.	Hurma (kakia)	10
12	Fragaria x ananassa Duch.	Luleshtrydhja	10
13	Ficus carica	Fiku	10
14	Zizyphus zizyphus	Hidja (xinxifja)	10
15	Juglans regia L.	Arra	10
16	Actinidia sp.	Kivi (Aktinidia)	10
17	Malus Mill.	Molla	10
18	Morus sp.	Mani	10
19	Mespilus germanica	Mushmolla dimërore	10
20	Eriobotrya japonica	Nespola	10
21	Olea europaea L.	Ulliri	10
22	Poncirus trifoliata	Trifoljata	10
23	Pistacia verra L.	Pistaku	10
24	Prunus amygdalus Batsch	Bajamja	10
25	Prunus armeniaca L.	Kajsia	10
26	Prunus avium L.	Qershia	10
27	Prunus cerasus	Vishnja	10
28	Prunus domestica L.	Kumbulla gjatore	10
29	Prunus persica (L.) Batsch	Pjeshka	10
30	Prunus Salicina Lindl	Kumbulla japoneze	10
31	Pyrus communis L.	Dardha	10
32	Punica granatum	Shega	10
33	Ribes spp.Ribes	Ribes	10
34	Rubus spp.	Mjedra	10
35	Vaccinium L.	Boronica	10
XI I	Bimët medicinale		Nr.Fidanëve
1	Salvia Officinalis	Sherebela	200
2	Thymus Vulgaris	Timus	200
3	Lavandula officinalis	Lavanda	200
4	Origanum Vulgaris	Rigoni	200

**SHTOJCA 4****MARRËVESHJE****PËR KRYERJEN E PROVAVE TË TESTIMIT TË VARIETETEVE**

E lidhur sot më datë _____, ndërmjet Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF) të përfaqësuar nga z. _____ drejtor i ESHFF-së dhe Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore _____, përfaqësuar nga z. _____ drejtor i QTTB-së _____ për kryerjen e provave të testimit të varietetit, të mbjella në vjeshtë/pranverë, për vitin _____ si më poshtë:

- a) Prova e testimit të varieteteve _____, vlera lekë _____.
 b) Prova e testimit të hibrideve _____, vlera lekë _____.

Marrëveshja është mbështetur në ligjin nr.10416, datë 4.7.2011, “Për materialin mbjellës shumëzues bimor”, dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kjo marrëveshje fillon më datë _____, përfundon më datë _____, afat që korrespondon me kohëzgjatjen e provës dhe ka vlerën e kontratës.

QTTB-ja _____ merr përsipër të kryejë provën e testimit varietor, sipas vlerës së miratuar me udhëzimin e përbashkët të ministrit të Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Financave, për tarifën për testimin e varietetit për regjistrimin në Katalogun Kombëtar (pika 7 e nenit 33, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011)

Palët bien dakord si më poshtë:**A. QTTB-ja _____ ka për detyrë:**

1. Të sigurojë sipërfaqen e tokës në sasinë dhe cilësinë e duhur.
2. Të sigurojë në kohë, sasi dhe cilësi bazën materiale që kërkohet për provën.
3. Të kryejë në afat shërbimet sipas metodikës dhe të ruajë provën nga dëmtimet.
4. Të kryejë në afat të gjitha matjet e provës.
5. Të plotësojë metodikën tip të varietetit të dërguar nga ESHFF-ja.
6. Të dorëzojë brenda afatit në ESHFF, metodikën e plotësuar.

B. Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve ka për detyrë:

1. Të sigurojë në kohë, sasi dhe cilësi farat e varieteteve që vihen në provë.
2. Të pajisë me metodikën e provës dhe skemën e vendosjes së saj.
3. Të ndjekë zbatimin dhe ecurinë e provave.
4. Të monitorojë hallkat kryesore të provës së testimit nga Sektori i Testimit.
5. Të shlyejë detyrimin financiar sipas situacionit të shpenzimeve për vlerësimin varietor.
6. Të miratojë ndryshim, shtesë/pakësim në preventiv për detyrimin financiar që ka me QTTB-në, bazuar në procesverbalin përkatës të hartuar për këtë qëllim.
7. Në përfundim të provës së testimit, ESHFF-ja merr mostrat për analizë, kurse prodhimin e provës e merr QTTB-ja _____.

Moszbatimi i detyrimeve për palët që nënshkruajnë këtë marrëveshje e bën të pavlefshme provën e testimit dhe ajo duhet të përsëritet. Shpenzimet e nevojshme për kryerjen e ritestimit, përballohen nga pala që nuk zbaton kërkesat e përcaktuara në këtë marrëveshje.

Marrëveshja përpilohet në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë dhe ka fuqi zbatuese nga punonjësit e tyre.

DREJTORI I QTTB

(_____)

DREJTORI I ESHFF

(_____)

**SHTOJCA 5****ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE.**

Raporti i ndërmjetëm për testimin për Dallueshmëri, Uniformitet dhe Stabilitet (DUS) të një varieteti përmban:

1. Numri referues i dorëzimit të raportit zyrtar;
2. Personi porositës i testimit;
3. Numri referues i personit porositës të testimit;
4. Caktimin/emërtimin e seleksionerit të varietetit;
5. Data e aplikimit të testimit;
6. Aplikanti (emri dhe adresa);
7. Përfaqësuesin e autorizuar për monitorimin e marrëveshjes;
8. Emri i species së cilës i përket varieteti /emri shkencor;
9. Emri i species së cilës i përket varieteti /emri i zakonshëm;
10. Emërtimi i varietetit;
11. Emri dhe adresa e seleksionerit;
12. Kontraktori për testim;
13. Vendi dhe vendndodhja e kryerjes së testimit;
14. Sezoni/stina e testimit;
15. Data dhe vendi i lëshimit të raportit të përkohshëm.
16. Të dhëna të përgjithshme:

- a) Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është i pasuksesshëm.
- b) Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor nuk i plotëson kërkesat.
- c) Testimi nuk u realizua (dështoi).

Vëzhgimet:

17. REZULTATET E TESTIMIT

- a) Nuk ka komente
- b) Komentet:

18. Data e planifikuar e raportit përfundimtar mbi testimet.

19. Shënim: Ky raport i ndërmjetëm nuk do të ndikojë në raportin përfundimtar.

Nënshkrimi i testuesit

**SHTOJCA 6****ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE.**

Raporti përfundimtar mbi testimin për Dallueshmëri, Uniformitet dhe Stabilitet (DUS) të një varieteti përmban:

1. Numri referues i dorëzimit të raportit zyrtar;
2. Personi porositës i testimit;
3. Numri referues i personit porositës të testimit;
4. Caktimi/emërtimi i seleksionerit të varietetit;
5. Data aplikimit të testimit;
6. Aplikanti (emri dhe adresa);
7. Përfaqësuesin e autorizuar për monitorimin e marrëveshjes;
8. Emri i species së cilës i përket varieteti / emri shkencor.
9. Emri i species së cilës i përket varieteti / emri i zakonshëm.
10. Emërtimi i varietetit.
11. Seleksioneri (emri dhe adresa).
12. Kontraktori për testim.
13. Vendi dhe vendndodhja e kryerjes së testimit.
14. Sezoni/stina e testimit.
15. Data dhe vendi i lëshimit të raportit përfundimtar.
16. Rezultatet e testimit për Dallueshmërisë, Uniformitetit dhe Stabilitet dhe konkluzione.

a) Raporti i dallueshmërisë

Varieteti:

- Është qartësisht i dallueshëm nga çdo varietet tjetër.
- Nuk është qartësisht i dallueshëm nga të gjitha varietetet e njohura.

b) Raporti i uniformitetit

Varieteti:

- Është mjaft uniform;
- Nuk është i mjaftueshëm uniform në lidhje me specifikat e riprodhimit seksual apo vegjetativ

c) Raporti mbi stabilitetin/qëndrueshmërinë.

Varieteti:

- Është stabël.
- Nuk është stabël për tiparet thelbësore të tij.

Në rast të rezultateve pozitive, përshkrimi i varietetit do t'i bashkëlidhet raportit.

17. Komentë:

Nënshkrimi



VENDIM

Nr. 320, datë 27.4.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 994, DATË 9.12.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN E
REGJISTRIMIT TË AKTEVE TË MARRJES
SË TOKËS NË PRONËSI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të tujëve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, dhe të neneve 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 6, e vendimit nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, riformulohet, si më poshtë vijon:

“6. Në çdo rast, kur është i nevojshëm hartimi i planvendosjes së ngastrave për regjistrim apo korigjimi dhe saktësimi i tyre, ato kryhen me shpenzimet e bashkive nëpërmjet topografëve të vet.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 322, datë 27.4.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 669, DATË 7.8.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
PËRCAKTIMIN, KRIJIMIN DHE
REALIZIMIN E KORNIZËS REFERUESE
GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH-
2010), SI METADATË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 4, të nenit 13, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe kudo në tekstin e vendimit e të rregullave bashkëlidhur tij, emërtimi “KRGJSH-2010” zëvendësohet me “KRGJSH”.

2. Në pikën 2, emërtimi “Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit” zëvendësohet me “Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike”.

3. Në tekstin e rregullave bashkëlidhur këtij vendimi bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në nenin 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Në paragrafin e dytë, të pikës 3, fjalët “... “Epoka 2010”, lidhet me kohën (1 janar 2010), në të cilën duhet të llogariten koordinatat e rrjetit shtetëror GPS...” , hiqen.

ii) Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. CORS (Continuously Operating Reference Stations) është rrjeti i stacioneve referencë të operimit të vazhdueshëm për përcaktimin e pozicionimit tredimensional në sipërfaqen e tokës, nëpërmjet sistemeve GNSS.”.

b) Në nenin 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Pika 1 riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Korniza Referuese Gjeodezike që do të përdoret në Republikën e Shqipërisë do të quhet “Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare” ose shkurt (KRGJSH).”.

ii) Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Përzgjedhja e realizimit të referencës evropiane dhe përcaktimi i epokës do të bëhen me vendim të ASIG-ut.”.

c) Neni 8 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 8

Rrjeti shtetëror GPS materializohet nëpërmjet ndërtimit të rrjetit shtetëror aktiv të stacioneve CORS dhe rrjetit shtetëror pasiv. Koordinatat e pikave të këtyre rrjeteve përcaktohen sipas KRGJSH-së.”.

ç) Pas nenit 8 shtohen nenet 8/1 e 8/2, me këtë përmbajtje:



“Neni 8/1

Stacionet bazë të rrjetit shtetëror aktiv CORS dhe pikat e rrjetit shtetëror pasiv të vendosen në territore të institucioneve shtetërore qendrore, vendore apo shkencore, të cilat duhet të garantojnë ruajtjen fizike të rrjeteve dhe funksionimin e pandërprerë me energji të stacioneve CORS. ASIG-u garanton përdorimin e të dhënave të rrjetit aktiv nga institucionet, për qëllime të veprimtarisë së tyre.

Neni 8/2

Stacionet mareografike të rrjetit shtetëror të KRGJSH-së materializohen në terren si bazë për përcaktimin e nivelit mesatar të detit. Stacionet mareografike ndërtohen në territore të reparteve ushtarake dhe Ministria e Mbrojtjes duhet të garantojë ruajtjen fizike dhe funksionimin e pandërprerë me energji të tyre.”

d) Neni 9 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 9

Radha e kryerjes së punimeve, përgatitja e instruksioneve me kërkesat teknike për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të parashikuara në nenin 5, përfshi këtu rrjetin shtetëror pasiv dhe rrjetin aktiv të stacioneve CORS, përcaktohen dhe miratohen nga ministri përgjegjës për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor me propozimin e ASIG-ut.”

dh) Në nenet 10 dhe 11 hiqet përcaktimi “2010”.

e) Shkronja “c” e shtesës I të vendimit riformulohet, si më poshtë vijon:

“c) Faktori dinamik i figurës së tokës pa përfshirë baticën e qëndrueshme: $J_2=108\,263 \times 10^{-8}$;Këtij faktori i korrespondon shtypja në pole: $1/f = 298.257\,222\,101$.”

ë) Paragrafi në fund të shtesës II të vendimit riformulohet, si më poshtë vijon:

“Ndarja dhe emërtesat e fletëve të hartave për shkallë më të mëdha se shkalla 1:2500 përcaktohet me vendim të ASIG-ut.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 323, datë 27.4.2016

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË
VENDIMIN NR. 391, DATË 6.5.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS
LIDHËSE MIDIS RRUGËVE “QEMAL
STAFI” DHE “ESAT BORDI”, SI DHE
NDËRTIMI I LULISHTES NË PJESËN
JUGORE TË BULEVARDIT “AQIF
PASHA”, TË “XHAMLLIKU PARA
SAHATIT”, NË BASHKINË E
ELBASANIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën e të shpronësuarve, që përmendet në pikën 3, bashkëlidhur vendimit nr. 391, datë 6.5.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Emri i pronares Sherife Doksani zëvendësohet me emrin e pronarit “NOA sh.a.”.

2. Shtohet emri i pronarit Bardhyl Stavri, me sipërfaqe 12.3 (dymbëdhjetë pikë tre) m², me vlerë 813 522 (tetëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e dy) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VKM-në
NR. 391, DATË 6.5.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Është në VKM

Emri, mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja në m ² që shpronësohet	Çmimi/m ²	Vlera/lekë	Shpronësimi/shuma/lekë	Dokument pronësie
Sherife Doksani	1/14-N11	8521	43.5	66140	2877090	2877090	Konf. nga ZRPP-ja
Bëhet							
NOA SHA	1/14-N11	8521	43.50	66140	2877090	2877090	Konf. nga ZRPP-ja

Shtohet

Bardhul Josif Stavri	1/316-ND	8521	12.30	66140	813522	813522	Konf. nga ZRPP-ja
----------------------	----------	------	-------	-------	--------	---------------	-------------------

**VENDIM****Nr. 324, datë 27.4.2016**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 432, DATË 2.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA HAPJA DHE SISTEMIMI I DISA SEGMENTEVE TË RRUGËS “11 NËNTORI” (SOT RRUGA “QEMAL STAFI”) NË QYTETIN E ELBASANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3, të vendimit nr. 432, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Për segmentin nga kthesa e stadiumit deri në bashkim me Unazën Jugore në lindje të qytetit, tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet lista me pronarët e rinj, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me një vlerë shpronësimi prej 1 344 701.20 (një milion e treqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e një pikë njëzet) lekësh;

2. Emri i pronarit Xhevit Shaban Seiti, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me emrin e pronarit Edi Ziu, sipas tabelës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

3. Për segmentin nga shkolla “Jorgji Dilo” deri te “Rotonda te Posta” (ana veriore), për pronarin Bledar Fatmir Duduci, vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 1 369 094.66 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë ndryshon dhe bëhet 1 096 668 00 (një milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë; për pronaren Shegushe Qamil Spahiu, vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 4 244 355 (katër milionë e dyqind e dyzet e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë ndryshon dhe bëhet 1 107 000 (një milion e njëqind e shtatë mijë) lekë, sipas tabelës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

4. Në segmentin nga shkolla “Jorgji Dilo” deri te “Rotonda te Posta” (ana veriore), vlerës së shpronësimit, prej 54 523 356.6 (pesëdhjetë e katër milionë e pesëqind e njëzet e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekësh, i shtohet vlera prej 6 007 758.6 (gjashtë milionë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë pikë gjashtë) lekësh, sipas tabelës 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VKM-në NR. 432, DATË 2.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Tabela1

Segmenti nga “Kthesa e stadiumit” deri në bashkim me Unazën Jugore në lindje të qytetit, ZK 8521

Shtohet në VKM

Nr.	Familja	Nr.	Vërtetim pronësie			Truall			Banesë				Njësi				Shpronësimi	Vërejtje
			m ²			Shprons.	Çmimi	Shpron.	Sip. banesës m ²		çmimi	shpronësim	Sip. njësisë m ²		çmimi	shpronësim	Shuma	
			truall	banesë	njësi	m ²	lekë/m ²	lekë	preket	shpron.	lekë/m ²	lekë	preket	shp.	lekë/m ²	lekë	lekë	
1	Luto Ibrahim Bani	16/57 6+1-1	0.00	174.24	0.00	0.00	9460	0.00	6.14	6.14	40940	251371.60	0.00	0.00	66140	0.00	251371.60	Hip “Bank. Soc. Gen. Alb.”
2	Luto Ibrahim Bani	16/57 6	90.60	0.00	0.00	3.07	9460	29042.20	0.00	0.00	40940	0.00	0.00	0.00	66140	0.00	29042.20	
1	Ilir Luto Bani	16/57 6+1-2	0.00	174.24	0.00	0.00	9460	0.00	6.14	6.14	40940	251371.60	0.00	0.00	66140	0.00	251371.60	Hip “Bank. Soc. Gen. Alb.”
2	Ilir Luto Bani	16/57 6	90.60	0.00	0.00	3.07	9460	29042.20	0.00	0.00	40940	0.00	0.00	0.00	66140	0.00	29042.20	
3	Ilir Luto Bani	16/57 7	72.40	17.40	0.00	7.56	9460	71517.60	4.33	17.40	40940	712356.00	0.00	0.00	66140	0.00	783873.60	

1344701.2

Tabela 2

Ndryshim emër pronari në VKM-në 432, datë 2.7.2014

Është në VKM

1	Xhevit Shaban Seiti	16/38 2	126.50	94.82		14.96	11218	167821.28	13.71	13.71	37982	520733.22	0.00	0.00	62582	0.00	688554.50	L.L1026-22.4.2009
---	---------------------	------------	--------	-------	--	-------	-------	-----------	-------	-------	-------	-----------	------	------	-------	------	-----------	-------------------

Bëhet

1	Edi Ziu	16/38 2	126.50	94.82		14.96	11218	167821.28	13.71	13.71	37982	520733.22	0.00	0.00	62582	0.00	688554.50	Konfirmuar nga ZRPP-ja
---	---------	------------	--------	-------	--	-------	-------	-----------	-------	-------	-------	-----------	------	------	-------	------	-----------	------------------------

Tabela 3

Ndryshim në VKM-në 432, datë 2.7.2014

Është në VKM

1	Bledar Fatmir Duduci	7/185	29.00	29.00	0.00	14.86	4081	60643.66	14.86	29.00	45119	1308451.00	0.00	0.00	69719	0.00	1369094.66	Konf. nga ZRPP-ja
2	Shegushe Qamil Spahiu	7/165	60.00	0.00	60.00	15.00	4081	61215.00	0.00	0.00	45119	0.00	15.00	60.00	69719	4183140.00	4244355.00	Konf. nga ZRPP-ja

5613449.66

Bëhet

1	Bledar Fatmir Duduci	7/185	29.00	29.00	0.00	14.86	4081	60643.66	0.00	0.00	45119	0.00	14.86	14.86	69719	1036024.34	1096668.00	Konf. nga ZRPP-ja
2	Shegushe Qamil Spahiu	7/165	60.00	0.00	60.00	15.00	4081	61215.00	0.00	0.00	45119	0.00	15.00	15.00	69719	1045785.00	1107000.00	Konf. nga ZRPP-ja

2203668.00

Tabela 4

Mbi disa ndryshime në VKM-në nr. 432, datë 2.7.2014 për shpronësimin për interes publik në Bashkinë e Elbasanit



Është në VKM “Lapsus”					Truall		Banesë/ndërtesë				Njësi			Shpronësimi			
Familja që shpronësohet	Nr.	m²			Shpron.	Çmimi	Shpronësimi	Sip. e banesës m²		Çmimi	Shpronësim	Sip. njësisë m²		Çmimi	Shpron.	Shuma	Vërejtje
	Pas.	truall	banesë	njësi	m²	lekë/m²	lekë	preket	shp.	lekë/m²	lekë	preket	Shpronës.	lekë/m²	lekë	lekë	
Rruga “11 Nëntori” ana veriore në VKM-në 432					2455.8		10022283		527.5		23798017		297		20 703 057.05	54 523 356.64	

Bëhet					Truall			Banesë/ndërtesë				Njësi			Shpronësimi		
Familja që shpronësohet	Nr.	m²			Shpronësim	Çmimi	Shpronësim	Sip. e banesës m²		Çmimi	Shp.	Sip. njësisë m²		Çmimi	Shp.	Shuma	Vërejtje
	pasurie	truall	banesë	njësi	m²	lekë/m²	lekë	preket	Shpronës.	lekë/m²	lekë	preket	Shpronës.	lekë/m²	lekë	lekë	
Rruga “11 Nëntori”, ana veriore në VKM-në 432					2629.6		10731398		527.5		23798017		373		26 001 701.05	6 0531 115.2	

6 007 758.56



VENDIM

Nr. 325, datë 27.4.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 205, DATË 9.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA HAPJA DHE NDËRTIMI I UNAZËS VERIORE, SEGMENTI A-B, NË LAGJEN “11 NËNTORI”, HAPJA DHE SISTEMIMI I ZGJATIMIT TË UNAZËS SË BRENDSHME, SEGMENTI QË BASHKON RRUGËN “28 NËNTORI” ME RRUGËN “RINIA”, SI DHE HAPJA E SISTEMIMI I ZGJATIMIT TË RRUGËS “LEF NOSI”, LAGJJA “5 MAJI”, SEGMENTI B-C, TË BASHKISË SË ELBASANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën e të shpronësuarve, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 205, datë 9.4.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

“Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pronarin Adem Sadi Shabani, ndryshon dhe bëhet 9 660 998.5 (nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë pesë) lekë, nga të cilat:

a) Tokë “truall”, me sipërfaqe 149 (njëqind e dyzet e nëntë) m², me vlerë 1 972 015 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëmbëdhjetë) lekë;

b) “Banesë”, me sipërfaqe 211.9 (dyqind e njëmbëdhjetë pikë nëntë) m², me vlerë 7 620 984 (shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë;

c) “Dru frutorë” në vlerë 68 000 (gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë”, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN NR. 205, DATË 9.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
(Segmenti nga kryqëzimi me rrugën “Ibrahim Dinqi” deri në bashkim me Unazën Veriore segmenti “B-C”), ZK 8525

Është në VKM

Nr.	Familja që shpronësohet	Nr. pas.	Vërt. pronësisë		Sip. tr. shp.	Vlera lekë/m ²	Vlera lekë	Sip. e banesës		Vlera lekë/ m ²	Shuma lekë Shp. ban	Dru frutorë lekë	Shuma shprons. banesë + truall+dru	
1	Adem Sadi Shabani	13/204	258.6	211.9	149	13235	1972015	18.11	18.11	35965	651326.15	68000	2691341.15	Likujd. nga bashkia
Bëhet														
1	Adem Sadi Shabani	13/204	258.6	211.9	149	13235	1972015	18.11	211.9	35965	7620983.5	68000	9660998.5	

**VENDIM****Nr. 326, datë 27.4.2016****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “BY-PASS FIER
(OBJEKTE)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass Fier (objekte)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “objekte”, me vlerë 22 953 116 (njëzet e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 22 953 116 (njëzet e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “BY-PASS FIER”

FSHATI	Nr.	Nr. i Pasurisë	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i Z. kad.	Ndërtim sip. m ²	Vlera në leke/m ² çmimi mestar	Vlera sipas çmimit mesatar	Vlera sipas preventivit	Vlera totale lekë	Lloji i objektit	Proces legalizimi	Shënime
Havaleas	1	92/9	Shefqet Ahmet Lushka	1471	38.6			498478	498478	1- kt Magazinë	Proces legalizimi	Akt marrëveshje, ligji nr. 8/2012, datë 9.2.2012
Havaleas	2	92/9	Shefqet Ahmet Lushka	1471	114	37240	4245360		4245360	1- kt Shtëpi banimi	Proces legalizimi	Akt marrëveshje, ligji nr. 8/2012, datë 9.2.2012
Havaleas	6	266/5	Idriz Seit Adili	1928	50			763829	763829	Magazinë 1- kt	Proces legalizimi	Akt marrëveshje, ligji nr. 8/2012, datë 9.2.2012
Dermenas	3	48/37	Vllaznim Shefqet Berisha	1471	236.1			9919667	9919667	Restorant 2- kt		Certifikatë pronësie
Petove	4	131/2	Asqeri Kaja	2944	129	37240	4803960		4803960	Banesë 1- kt.	Proces legalizimi	Akt marrëveshje, ligji nr. 8/2012, datë 9.2.2012
Petove	5	130/9	Arjan Shyqyri Kaja	2944	48.4	37240	1802416	186534	1988950	Banesë + ambiente ndihmese	Proces legalizimi	Akt marrëveshje, ligji nr. 8/2012, datë 9.2.2012
Mbrostar	7	124/14	Vito Azbi Serjanaj	2636	30.8			732872	732872	Ambient ndihmës 1-kt		Konfirmuar ZVRPP-ja
			SHUMA TOTALE						22953116			

**VENDIM****Nr. 327, datë 27.4.2016****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS
110 kv RRASHBULL–GOLEM - KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV Rrashbull–Golem - Kavajë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, shpronësohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “tokë arë”, me sipërfaqe 3 254.97 (tre mijë e dyqind e

pesëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e shtatë) m², në shumën 967 956.8 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit prill 2016.

6. Çdo pronar, për t’u likuiduar për efekt shpronësimi, të dorëzojë pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a) dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar, lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Durrës dhe Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS
110 kV RRASHBULL–GOLEM

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë arë - Kavajë

Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. shpronësim për shtyllë m²	Vlera e shpronësimit në lekë/m²	Vlera e shpronësimit në lekë për shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia, sip. pronës m²				
FSHATI RRASHBULL												
					3215							
1	110	Tefik	Muharrem	Kalluli	3215	59/4	Arë	2835	17.4	227	3949.8	
2	1	Tefik	Muharrem	Kalluli	3215	59/4			82.92	227	18822.8	
3	2A	Fatmir		Fraholli	3215	59/3	Arë	300	51.84	227	11767.7	
4	2	Isuf	Kasem	Dervishi	3215	53/6	Arë	3500	34.33	227	7792.9	
		Pretendues				53/7	Arë	2500				
5	3	Pretendues			3215		Arë		96.04	227	21801.1	
6	4	Pretendues			3215		Arë		106.27	227	24123.3	
7	5	Pretendues			3215		Arë		34.33	227	7792.9	
8	6	Pretendues			3215		Arë		77.33	227	17553.9	
9	7	Pretendues			3215		Arë		74.02	227	16802.5	
10	8	Pretendues			3215		Arë		62.5	227	14187.5	
11	9	Pretendues			3215		Arë		34.33	227	7792.9	
FSHATI ARAPAJ												
					1031							
12	11	Muharrem	Ibrahim	Pajaziti	1031	126/14	Arë	1150	94.09	356	33496.0	
13	12	Pretendues			1031	192/7 192/8	Arë	8700	77.33	356	27529.5	
14	14	Besim	Kadri	Troplini	1031	242/10	Arë	3760	42.82	356	15243.9	
15	15	Pretendues			1031		Arë		34.33	356	12221.5	
16	16	Pretendues			1031		Arë		41.46	356	14759.8	
FSHATI SHKALLNUR												
					3385							
17	17	Ramazan	Seit	Mucaj	3385	133/2	Arë	2500	94.09	227	21358.4	
18	18	Eqerem	Sabri	Muca	3385	133/5	Arë	7400	43.88	227	9960.8	
19	13 A	Mustafa	Jakup	Dervishi	3385	146/1-2	Arë	540	51.84	227	11767.7	
20	19	Bashkëpronësi			3385	131/1	Arë	1350	58.32	227	13238.6	
21	20	Demir	Ramazan	Xhafa	3385	264/16	Arë	4900	40.56	227	9207.1	
22	21	Pretendues			3385		Arë		34.33	227	7792.9	
	22	Bashkëpronësi		Berberi	3385	433/5	Arë	2000	34.33	227	7792.9	
24	23	Pretendues			3385	490/4 491/1-10	Arë		34.33	227	7792.9	
25	24	Gezim		Copa	3385	535/8	Arë	2400	34.33	227	7792.9	
26	25	Robert		Myfollari	3385	565/20	Arë	7000	48.72	227	11059.4	
		Mynyre		Puja		565/21	Arë	6000				
FSHATI KRYEMËDHENJ												
					2291							
27	26	Pretendues			2291	3/2 -	Arë		58.32	345	20121.7	
28	27	Xhemile	Ahmet	Sinarezi	2291	16/5/1	Arë	2300	34.33	345	11843.1	
29	28	Bashkëpronësi		Dervishi	2291	26/2	Arë	2140	34.33	345	11843.1	
30	29	Azem	Islam	Dervishi	2291	70/6	Arë	1000	34.33	345	11843.1	



		Fatmir	Islam	Dervishi		70/7		1100				
31	30	Haxhi	Abdulla	Istrefi	2291	135/9	Arë	950	34.33	345	11843.1	
32	31	Hamid Shtet	Reshat	Shirja	2291	169/2 196/7	Arë	1000	34.33	345	11843.1	
33	32	Bashkëpronësi		Shirja	2291	167/6	Arë	4600	77.33	345	26680.4	
34	33	Pretendues			2291	215/3	Arë		34.33	345	11843.1	
35	34	Petrit	Shefik	Tila	2291	215/7	Arë	10100	34.33	345	11843.1	
36	36	Pretendues			2291		Arë		58.32	345	20121.7	
37	37	Pretendues			2291	423/2 423/2	Arë		77.33	345	26680.4	
38	38	Pretendues			2291	425/8	Arë		47.33	345	16330.4	
FSHATI GOLEM												
					1791							
39	39	Pretendues			1791		Arë		112.36	345	38764.2	
40	40	Pretendues			1791		Arë		112.36	345	38764.2	
41	41	Pretendues			1791		Arë		40.56	345	13993.2	
42	31 A	Pretendues					Arë		73.96	345	25516.2	
43	42	Pretendues			1791		Arë		77.33	345	26678.9	
44	43	Pretendues			1791		Arë		34.33	345	11843.9	
FSHATI AGONAS												
					3961							
45	45	Lutfi	Masar	Zikullari	3961	8/1 -	Arë	10000	34.33	238	8170.5	
FSHATI AGONAS												
					3961							
46	47	Pretendues			3961	172/4	Arë		77.33	238	18404.5	
47	48	Besim	Beshir	Spanjollli	3961	35/4	Arë	5220	34.33	238	8170.5	
48	49	Xhevat	Zequir	Çopa	3961	70/4	Arë	12270	34.33	238	8170.5	
49	50	Idajet	Vath	Rruga	3961	71/3	Arë	2000	34.33	238	8170.5	
FSHATI KANAPARAJ												
					2071							
50	51	Pretendues		Spanjollli	2071	511/4	Arë		36.59	345	12623.6	
51	52	Pretendues			2071	512/25	Arë		54.61	345	18840.5	
52	53	Ibrahim	Shefjet	Kanapari	2071	512/20	Arë	12200	82.39	345	28424.6	
53	54	Ylli	Shefik	Kola	2071	750/14	Arë	3600	40.56	345	13993.2	
		Selman	Shaqir	Spanjollli		750/15	Arë	6400				
54	55	Bashkëpronësi		Çopa	2071	749/6	Arë	6000	132.25	345	45626.3	
BASHKIA KAVAJË												
KAVAJË												
					8551							
55	56	Pretendues			8551	2/						S'ka informacion
56	57	Pretendues			8551	1/						S'ka informacion
57	58	Pretendues			8551	1/						S'ka informacion
58	59	Pretendues			8551	5/201						S'ka informacion
FSHATI GOLEM												
					1791							
59	62	Pretendues			1791	87	Arë		112.36	345	38764.2	
60	63	Pretendues			1791	88	Arë		58.32	345	20120.4	
61	64	Pretendues			1791	56	Arë		77.33	345	26678.9	
Sipërfaqe totale për shpronësim në m²									3254.97			
Shuma totale në lekë për shpronësim											967956.8	

**UDHËZIM****Nr. 10, datë 3.5.2016**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 3.11.2014,
“PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË
VEÇANTË TË SKEMËS SË
KOMPENSIMIT TË PRODHUESVE
BUJQËSORË PËR QËLLIME TË
TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në fund të pikës 2, të nenit 5, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“Për aktivitetin prodhues bujqësor që kryhet në të njëjtin vend/adresë (tokë bujqësore ose adresë ku kryhet veprimtaria bujqësore/blegtorale) në pronësi ose në përdorim, ky vërtetim, për qëllime të pajisjes me NIPT, lëshohet vetëm në emër të një fermeri.”.

2. Shkronjat “a” dhe “b” në pikën 4, të nenit 5, ndryshojnë me përmbajtjen e mëposhtme:

“Për pajisjen me NIPT të fermerit janë të detyrueshme këto të dhëna:

a) të dhënat e identifikimit të fermerit, adresa e banimit, kontakte të personit;

b) vendi i ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore. Për të njëjtin vend të veprimtarisë /adresë të ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore, pajiset me NIPT, vetëm një fermer i cili ka në pronësi ose në përdorim dhe ushtron veprimtarinë në këtë vend.”.

3. Fjalja e dytë në pikën 3, të nenit 9, “E drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar” shfuqizohet dhe pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“5. Personi i tatueshëm, blerës me qëllim, që të ketë të drejtën e zbritjes së normës së kompensimit të TVSH-së të paraqitur në faturën tatimore të lëshuar sipas këtij neni, për transaksione mbi 30 000 lekë, është i detyruar të kryejë likuidimin e vlerës së faturës nëpërmjet shërbimit të Postës Shqiptare ose nëpërmjet bankës, nëse vlera e

Faqe|4350

transaksionit nuk e kalon shumën prej 150 000 lekësh dhe nëpërmjet likuidimit nga llogaria bankare e tij në llogarinë bankare të fermerit, për transaksione, vlera e të cilit është më e madhe se 150 000 lekë, siç përcaktohet në nenin 59 të ligjit, “Për procedurat tatimore në RSH”.

Për transaksione sipas vlerës totale të faturës deri në 30 000 lekë, likuidimi me para në dorë vërtetohet me dokumentet përkatëse të kontabilitetit për dokumentimin e pagesave, duke pasur parasysh kushtin se brenda së njëjtës ditë, me të njëjtin fermer, nuk lejohet të kryhet më shumë se një transaksion deri në këtë vlerë.

6. Personi i tatueshëm blerës që eksporton produkteve e blera nga fermerët sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së u nënshtrohet rregullave të përcaktuara në nenin 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Personat e tatueshëm blerës që karakterizohen me risk zero sipas kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave, rimbursohen për TVSH-në, automatikisht, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.”.

4. Në nenin 10, pas pikës 4 shtohen pikat 5, 5.1, 5.2, 5.3, 5.4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“5. Personi i tatueshëm blerës i produkteve të fermerit, i cili për zbatimin e kësaj skeme ngarkohet të lëshojë faturë tatimore, jo vetëm për shijet që kryen, por edhe faturë në emër të fermerit si blerës i produkteve të tij, lejohet të përdorë faturë tatimore kompjuterike me numër serial unik dhe të papërsëritshëm të printuar nga sistemi i tij i regjistrimeve.

5.1 Për këtë qëllim, personi i tatueshëm duhet të paraqesë:

a) Një kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, në të cilën të tregojë se sistemi i tij i regjistrimeve është i kompjuterizuar dhe i aftë të prodhojë fatura tatimore me numër serial unik dhe të papërsëritshëm për çdo transaksion dhe që lëshon një numër të konsiderueshëm faturash;

b) Modelin e faturës kompjuterike që kërkon të përdorë, model i cili duhet të përmbajë të gjitha të dhënat në përputhje me pikën 1 dhe 2 të këtij neni.

Drejtorja Rajonale Tatimore, sigurohet që fatura tatimore kompjuterike përmban të gjitha të dhënat e nevojshme dhe brenda 7 ditëve, një kopje të kërkesës, modelin e faturës tatimore kompjuterike



dhe opinionin e saj e dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

5.2 Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda 7 ditësh miraton përdorimin e faturës tatimore kompjuterike, sipas modelit të kërkuar dhe njofton personin e tatueshëm dhe drejtorinë rajonale tatimore, e cila i dorëzon personit të tatueshëm zyrtarisht diapazonin e numrave serialë që duhet të përmbajë çdo faturë. Çdo faturë e lëshuar sipas modelit të miratuar përmban detyrimitsh shënimin, “Përdorimi i kësaj fature është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me shkresën nr. ..., datë...”.

5.3 E drejta për të përdorur modelin e miratuar të faturës tatimore kompjuterike për personin e tatueshëm fillon pasi është pajisur me diapazonin e numrave serialë që duhet të përmbajë çdo faturë. Numri serial është unik dhe i papërsëritshëm për çdo faturë të lëshuar.

5.4 Për çdo ndryshim në modelin, përmbajtjen, formatin e faturës kompjuterike për të cilën është miratuar e drejta e përdorimit, personi i tatueshëm duhet të kërkojë miratim të modelit të ndryshuar të faturës tatimore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 336 lekë